

HULUMTIMI

**mbi Incidentet online dhe offline të dhunës
ndaj grave të reja dhe vajzave në hapësirën
publike në Maqedoninë e Veriut**

Titulli:

HULUMTIMI mbi Incidentet online dhe offline të dhunës ndaj grave të reja dhe vajzave në hapësirën publike në Maqedoninë e Veriut

Redaktore:

dr. Zhaneta Poposka nga Misioni i OSBE-së në Shkup

Autor:

Indago

Korrektura gjuhësore:

Korrekturë gjuhësore në versionin maqedonisht: Martina Zhuzhellovska

Korrekturë gjuhësore në versionin anglisht: Lazar Popov

Korrekturë gjuhësore në versionin shqip: Fetije Topojani

Përkthimi:

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe: Gazmend Qoku

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën angleze: Ida Blazhevska

978-92-9271-684-4



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Materialet në këtë botim janë vetëm për referim. Edhe pse OSBE-ja ka përkushtuar kujdes të madh në zhvillimin e tij, e njëjta nuk merr asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara, apo për ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk e pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së. Për këto arsye, asnjë pretendim nuk mund të bëhet kundër OSBE-së lidhur me pasojat e mundshme nga besueshmëria e informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë botim.

Përmbajtja

Përmbledhja ekzekutive	6
Metodologjia dhe vëllimi i hulumtimit	16
Qëllimi i hulumtimit	17
Metodologjia e hulumtimit	18
Hulumtimi kuantitativ	18
Hulumtimi kualitativ	18
Rezultatet	19
Perceptimi dhe pikëpamjet lidhur me DHBGJ dhe konteksti institucional	19
Vlerësimi i situatës së sigurisë	19
Puna e institucioneve në mbrojtje nga DHBGJ	22
Institucionet kryesore për luftimin e DHBGJ	23
Njohuritë në lidhje me DHBGJ	27
Pikëpamjet në lidhje me DHBGJ	31
Format dhe përhapja e DHBGJ dhe/ose ngacmimit	36
Problemet më të mëdha	36
Ndjenja e sigurisë në hapësirën publike	38
Prevalenca e dhunës	39
Format e dhunës	43
Raportimi i dhunës	45
Arsyet e mosraportimit	46
Mekanizmat e luftimit	48
Boshllëqet në mbrojtjen institucionale dhe ligjore	50
Faktorët e sigurisë më të madhe	51
Qasshmëria e institucioneve	53
Mjedisi online dhe dhuna digjitale	55

Prevalenca e dhunës në hapësirën digjitale	55
Format e dhunës në hapësirën digjitale	56
Platformat	58
Raportimi i dhunës	59
Mekanizmat e luftimit	61
Faktorët e DHBGJ në hapësirën digjitale	63
Faktorët e sigurisë më të madhe	64
Konkluzione dhe rekomandime	66
Konkluzione	67
Rekomandime	69
Anekse	71
Aneksi 1 - Pyetësi	71
Aneksi 2 - Udhëzuesi për diskutim në grupet fokus	94

Lista e grafikëve

Grafiku 1: Ndjenja e sigurisë në hapësirën publike	19
Grafiku 2: Aktiviteti/vendi i shmangur për shkak të frikës nga DHBGJ	21
Grafiku 3: Besimi në institucionet	22
Grafiku 4: Roli kryesor në luftimin e DHBGJ	24
Grafiku 5: Reagimi i duhur nga institucionet	26
Grafiku 6: Informacione për DHBGJ	27
Grafiku 7: Arsyet e mosraportimit të DHBGJ	28
Grafiku 8: Ndërgjegjësimi për ekzistimin e shërbimeve	30
Grafiku 9: Pikëpamjet themelore për DHBGJ	31
Grafiku 10: Normat e sjelljes së pranueshme	33
Grafiku 11: Pikëpamjet ndaj grupeve të ndryshme të grave të reja dhe/ose vajzave	35
Grafiku 12: Problemet më të mëdha	37
Grafiku 13: Ndjenja e sigurisë	39
Grafiku 14: Prevalenca e dhunës	41
Grafiku 15: Raportimi i dhunës	45
Grafiku 16: Arsyet e mosraportimit	47
Grafiku 17: Hapat e ndërmarra	49
Grafiku 18: Boshllëqe në mbrojtjen institucionale dhe ligjore	51
Grafiku 19: Faktorët e sigurisë më të madhe	52
Grafiku 20: Mënyrat e institucioneve më të qasshme	54
Grafiku 21: Përvoja me dhunën në hapësirën digjitale	55
Grafiku 22: Format e DHBGJ në hapësirën digjitale	57
Grafiku 23: Platforma ku është përjetuar/dëshmuar dhuna	58
Grafiku 24: Raportimi i dhunës në hapësirën digjitale	59
Grafiku 25: Arsyet e mosraportimit	60
Grafiku 26: Veprimet e ndërmarra	62
Grafiku 27: Faktorët e DHBGJ në hapësirën digjitale	64
Grafiku 28: Faktorët e sigurisë më të madhe	65

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE



Ky raport i pasqyron rezultatet e hulumtimit mbi dhunën me bazë gjinore dhe ngacmimin ndaj grave të reja dhe vajzave nga mosha 18 deri në moshën 29 vjeç në Maqedoninë e Veriut, të zbatuar në vitin 2025 me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup dhe në bashkëpunim me Zyrën e Presidentes të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Hulumtimi synon të përcaktojë përhapjen, natyrën dhe perceptimin e formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore, si dhe efektivitetin dhe qasshmërinë e institucioneve për mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave nga dhuna me bazë gjinore. Për më tepër, hulumtimi përqendrohet edhe në format online të dhunës, të cilat janë gjithnjë e më sfiduese në kontekstin e transformimit digjital të shoqërisë.

Metodologjia

Hulumtimi u zbatua në një model reprezentativ prej 600 të anketuarave nga të gjitha rajonet planifikuese të vendit, përmes sondazheve të strukturuar ballë për ballë në gjuhën maqedonase dhe shqipe, me një gabim statistikor prej $\pm 3.9\%$. Përveç pjesës kuantitative, u organizuan edhe katër grupe fokus me pjesëmarrjen e përfaqësuesve dhe përfaqësuesve të organizatave qytetare dhe ekspertëve/eve në fushën e të drejtave të njeriut dhe barazisë gjinore. Kombinimi i metodave siguroi një analizë të thellë të përvojave individuale, perceptimeve shoqërore dhe praktikave institucionale.

Gjetjet e Hulumtimit

Perceptimi dhe ndjenja e sigurisë

- ▶ Dy të tretat (74%) e grave të reja dhe vajzave deklaruan se ndihen të pasigurta në hapësirën publike për shkak të seksit të tyre, ndërsa 27% asnjëherë nuk kishin përjetuar një ndjenjë të tillë.
- ▶ Gratë e reja dhe vajzat shqiptare në një përqindje dukshëm më të lartë (90%) janë ndjerë të paktën në një moment të pasigurta në hapësirën publike në krahasim me gratë e reja dhe vajzat maqedonase (66%), gratë e reja dhe vajzat rome (77%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera etnike (74%).
- ▶ 27% e të anketuarve i janë shmangur ndonjë aktiviteti ose vizite në një vend të caktuar për shkak të frikës nga dhuna, me ç'rast nivele më të larta të shqetësimit janë vërejtur te grup mosha më e re (18-21 vjeç) dhe te popullata rome (57%).

Nga ana tjetër, gratë e reja dhe vajzat që vijnë nga familje me status më të ulët ekonomik (43%), pa arsim formal (49%) dhe nga rajoni verilindor i vendit (42%) kanë më shumë gjasa të shmangin aktivitetin ose vendin për shkak të frikës nga DHBGJ dhe/ose ngacmimi.

- ▶ Një ndjenjë sigurie është e lidhur fort me statusin ekonomik, me ç'rast gratë e reja dhe vajzat nga familjet me të ardhura më të ulëta shpesh ndihen më të rrezikuara.

Institucionet e parandalimit dhe mbrojtjes nga DHBGJ

- ▶ Besimi më i lartë shprehet për institucionet arsimore (67%) dhe shëndetësore (62%), pasuar nga policia (55%), qendrat për punë sociale (51%) dhe organizatat qytetare (50%)-, ndërsa besimi më i ulët është ndaj gjyqësorit (38%) dhe prokurorisë (41%).
- ▶ Policia u identifikua si institucioni më i rëndësishëm gjatë trajtimit të dhunës me bazë gjinore (69%) pastaj qendrat për punë sociale (61%), por në grupet fokus u analizuan si reaktive dhe jo gjithmonë efektive.
- ▶ Gjysma e të anketuarave (51%) janë të mendimit se institucionet reagojnë në mënyrë adekuate ndaj parandalimit dhe ndëshkimit të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit të grave të reja dhe vajzave, ndërsa një shkallë e lartë prej 40% e të anketuarave nuk e ndajnë këtë mendim.

Njohuritë në lidhje me DHBGJ

- ▶ Shumica e grave dhe vajzave të reja (71%) kanë informacione për të identifikuar dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin. Megjithatë, çdo e katërta grua e re ose vajzë (27%) deklaroi se nuk ka informacione të mjaftueshme për të identifikuar dhe kërkuar mbrojtje nga DHBGJ. Kjo përqindje është veçanërisht e lartë midis romeve (47%), si dhe tek ato pa arsim formal (50%) ose vetëm me arsim fillor (49%).
- ▶ Arsyet kryesore për mos raportim janë: frika (58%), mosbesimi ndaj institucioneve (56%), turpi (50%). Presioni familjar manifestohet në një përqindje dukshëm më të lartë tek gratë e reja dhe vajzat rome (53%) krahasuar me përqindjen mesatare (25%). Turpi si shkak paraqitet në një përqindje dukshëm më të lartë (66%) tek gratë e reja dhe vajzat me arsim fillor në krahasim me të anketuarat me arsim të lartë.
- ▶ Gjysma e grave të reja dhe vajzave mendojnë se nuk ekzistojnë (30%) ose nuk e dinë se ekzistojnë (21%) shërbime rinore dhe të ndjeshme gjinore për të mbështetur viktimat e DHBGJ. Ndërgjegjësimi është veçanërisht i ulët midis romeve të reja (18 deri në 21 vjeç), dhe tek gratë e reja dhe vajzat pa arsim formal ose me arsim fillor. Vetëm 7% e grave të reja dhe vajzave e dinë se ekzistojnë shërbime rinore dhe të ndjeshme gjinore.

Pikëpamjet në lidhje me DHBGJ

- ▶ Tri nga pesë të anketuara nuk pajtohen me pikëpamjet se dhuna në familje është çështje private dhe duhet të mbetet në familje (61%), se dhuna është shkaktuar nga vetë viktimat (67%) dhe se gratë shpikin ose ekzagjerojnë me pohimet për abuzim (65%). Një nga katër të anketuara konsideron se gratë përdhunohen më shpesh nga kryerës të panjohur sesa nga ata që i njohin (27%).
- ▶ Pikëpamjet negative ndaj dhunës me bazë gjinore janë më të pranishme te gratë e reja dhe vajzat me status më të ulët ekonomik, te ndonjë përkatësi e caktuar etnike (kryesisht shqiptare dhe rome) dhe nga zonat rurale. Këto të anketuara më shpesh besojnë se dhuna në familje është çështje private, se viktimat është ajo që shkakton dhunën dhe se gratë që raportojnë abuzimin shpesh ekzagjerojnë.
- ▶ Rezultatet tregojnë se shumica e grave të reja dhe vajzave i kundërshtojnë pikëpamjet tradicionale të nënshtimit femëror - 80% nuk pajtohen me atë se gruaja është e detyruar të ketë marrëdhënie seksuale pa dëshirën e saj, kurse 75% nuk pajtohen me atë se burri duhet të jetë "kryesor" në marrëdhënien. Megjithatë, është shqetësuese që 31% i normalizojnë veshjet provokuese si shkak i dhunës, 24% fajësojnë viktimën dhe 20% nuk e identifikojnë ngacmimin seksual, megjithëse 66% e mbështesin ndërhyrjen e jashtme në rastet e dhunës dhe 71% e mbrojnë lirinë e gruas në zgjedhjen e miqve.
- ▶ Të anketuarat i identifikojnë faktorët interseksional, përkatësinë etnike (42%), aftësinë e kufizuar (41%) dhe vendbanimin (37%) si të rëndësishëm për rrezikun nga dhuna me bazë gjinore, por statusi socio-ekonomik është me ndikim më të madh. Pothuajse gjysma e tyre (46%) mendojnë se gratë me status më të ulët socio-ekonomik janë më të ekspozuara ndaj dhunës dhe se ky faktor ndikon më së shumti në mënyrën se si trajtohen viktimat.

Format dhe përhapja e DHBGJ

- ▶ Sipas të anketuarave, problemet financiare dhe paqëndrueshmëria ekonomike janë sfidat më të shpeshta me të cilat përballen gratë e reja dhe vajzat □ 23% i theksojnë ato si problem primar, ndërsa gjithsej 30% si një problem i rëndësishëm, veçanërisht në mesin e punonjëseve të përkohshme (41%), të papunësuar (37%) dhe grave të përkatësisë etnike rome (60%). Pas këtyre pasojnë ndjenja e pasigurisë në hapësirën publike (16%), shëndeti mendor (12%) dhe ngacmimi onlajn (16%) midis më të rejave në grup moshën 18-21 vjeç, ndërsa diskriminimi është më i shpeshtë në mjediset rurale (13% kundrejt 8% në mjediset urbane).

- ▶ Gratë e reja dhe vajzat ndihen më pak të sigurta në vende më të mëdha dhe virtuale (siç është hapësira digjitale). Kështu, 44% e grave të reja dhe vajzave ndihen të pasigurta në hapësirën digjitale, kurse 37% në vende publike si sheshe, parqe dhe rrugë, ndërsa 34% në transportin publik. Nga ana tjetër, 89% e grave të reja dhe vajzave ndihen të sigurta në fqinjësinë e tyre kurse 79% në qytetin/fshatin e tyre dhe në institucionet arsimore.
- ▶ Sipas të anketuarave, format më të shpeshta të dhunës ndaj grave të reja dhe vajzave janë dhuna verbale (33% si dëshmitare, 24% si viktimë), psikologjike (24% si dëshmitare dhe 16% si viktimë) dhe fizike (22% si dëshmitare dhe 12% si viktimë), ndërsa dhuna ekonomike dhe seksuale si dhe ngacmimi raportohen në një përqindje më të vogël.
- ▶ Gratë e reja dhe vajzat e përkatësisë etnike rome janë ekspozuar më së shumti ndaj dhunës - 47% kanë përjetuar dhunë verbale, 40% dhunë psikologjike dhe 27% dhunë fizike. Ngacmimi seksual është mbi mesataren të gratë e reja dhe vajzat nga mjediset rurale (10%) dhe të rejtat shqiptare (10%).
- ▶ Dhuna psikologjike dhe digjitale vlerësohen si format më të fshehura dhe më pak të sanksionuara.
- ▶ Dhuna ndaj grave të reja dhe vajzave është e përhapur kudo, dhe më së shpeshti ndodh në shtëpi (24%), ku dhuna kontrolluese dhe ekonomike raportohet nga 49% dhe 65% e të anketuarave, gjë që vë në dukje varësinë dhe kontrollin në marrëdhëniet intime. Sipas të anketuarave, ngacmimi seksual (64%) dhe vëzhgimi (68%) mbizotërojnë në hapësirën publike, dhuna psikologjike dhe verbale ndodhin më shpesh në institucionet arsimore (deri në 45%), ndërsa dhuna psikologjike (14%) dhe ekonomike (15%) janë të pranishme në vendin e punës, kurse në shtëpitë e miqve dhe konviktet e studentëve ngacmimi seksual arrin në 43%.

Raportimi dhe përgjigja institucionale

- ▶ Vetëm 5% e viktimave që kanë përjetuar ose kanë qenë dëshmitare të dhunës e kanë raportuar incidentin, ndërsa 89% jo. Këto të dhëna janë alarmante dhe tregojnë se dhuna me bazë gjinore ndaj grave të reja dhe vajzave më së shpeshti mbetet e fshehur.
- ▶ Arsyet kryesore për mosraportimin midis grave të reja dhe vajzave që shfaqen si viktimë ose si dëshmitare të DHBGJ janë: frika (31%), mosbesimi ndaj institucioneve (27%), turpi (21%) dhe informimi i pamjaftueshëm (16%).
- ▶ Pas përjetimit të një incidenti të dhunës me bazë gjinore, të anketuarat që janë paraqitur si viktimë ose dëshmitare të DHBGJ kryesisht kërkuar mbështetje emocionale nga familja ose nga personat e afërt (34%), dhe jo nga institucionet zyrtare, 31% janë larguar nga mjedisi i dhunshëm, ndërsa vetëm 7% kanë kërkuar ndihmë profesionale psikologjike.

Mangësitë institucionale

- ▶ Dobësitë më të mëdha në veprimet e institucioneve janë ndëshkimi i pamjaftueshëm i autorëve (65%), mbrojtja dhe mbështetja e pamjaftueshme e viktimave (56%) dhe reagimi i ngadaltë institucional (55%), gjë që krijon një ndjenjë mosndëshkimi dhe mosbesimi ndaj sistemit.
- ▶ Përveç kësaj, të anketuarat e vunë në dukje nevojën për parandalim dhe informacion më të mirë (35%), bashkëpunim më efektiv ndërinstitutional (31%), trajnim dhe ndjeshmëri më të madhe të personave zyrtarë (29%) gjatë trajtimit të rasteve të dhunës me bazë gjinore.
- ▶ Në mënyrë që institucionet të bëhen më të qasshme dhe më të besueshme, gratë e reja dhe vajzat më së shumti kërkojnë besueshmëri dhe mbrojtje të të dhënave personale (62%), ndërsa 52% presin një qasje të personalizuar dhe të ndjeshme, 45% fushata për rritjen e ndërgjegjësimit dhe besimit dhe 41% qasje më të lehtë fizike dhe online në shërbime pa procedura komplekse.

Masat e përmirësimit të sigurisë

Masat më shpesh të propozuara për të rritur sigurinë janë:

- ▶ Reagimi më i shpejtë institucional (48%),
- ▶ Mbështetja më e madhe nga policia dhe shërbimet sociale (46%),
- ▶ Ndriçimi dhe infrastruktura më e mirë në hapësirat publike (34%),
- ▶ Fushata informative dhe edukative (26%),
- ▶ Qëndrueshmëria dhe qasshmëria e shërbimeve ekzistuese për viktimat (25%).

Dhuna me bazë gjinore në hapësirën digjitale

- ▶ 10% e grave të reja dhe vajzave kanë qenë viktime të kësaj forme të dhunës me bazë gjinore ndërsa 15% kanë qenë dëshmitare të dhunës në hapësirën digjitale.
- ▶ Format më të shpeshta të DHBGJ në hapësirën digjitale janë: krijimi i profileve të rreme (55%), komentet ofenduese (45%), thirrjet telefonike ose mesazhet SMS (33%), mesazhet seksualisht eksplicite pa pëlqim (25%) dhe vëzhgimi onlajn (23%).
- ▶ Platformat më të rrezikshme për përdorim janë Facebook (74%), Instagram (41%) dhe TikTok (18%).
- ▶ Vetëm një prej dhjetë grave të reja ose vajzave që kanë përjetuar ose dëshmitare të DHBGJ në hapësirën digjitale e ka raportuar incidentin ndërsa këtë e ka bërë më së shpeshti në polici ose në vetë rrjetin social ku ka ndodhur dhuna.

- ▶ Faktorët kryesorë që kontribuojnë në shfaqjen e dhunës onlajn janë mungesa e sanksioneve (50%), anonimiteti (41%) dhe përhapja e lehtë e përmbajtjeve fyese (39%). Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarave, mes tjerash, i theksuan platformat e rregulluara jo sa duhet (29%), edukimin e pamjaftueshëm për të drejtat digjitale (27%) dhe normalizimin e të folurit agresiv dhe sjelljes së dhunshme (27%).
- ▶ Gratë e reja dhe vajzat mendojnë se për një siguri më të madhe në hapësirën digjitale thelbësore janë mbështetja institucionale (51%), rregullat e qarta dhe të rrepta në platformat online (45%) dhe instrumentet digjitale të qasshme për raportimin dhe bllokimin e dhunuesve (43%).

Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzione

1. Hulumtimi vë në dukje se dhuna me bazë gjinore është një fenomen i rrënjosur thellë dhe shpesh i panjohur, i cili vazhdon për shkak të mungesës së sanksioneve, joefikasitetit institucional dhe normalizimit të sjelljes së dhunshme. Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna digjitale ndaj grave të reja dhe vajzave është një problem serioz dhe në rritje që kërkon një qasje sistemike dhe të koordinuar. Siguria e grave të reja dhe vajzave është një problem shumëdimensional që kërkon qasje institucionale, infrastrukturore dhe arsimore.
2. Të dhënat konfirmojnë se besimi institucional midis grave të reja është i pjesshëm. Megjithatë ndërgjegjësimi midis të rinjve është rritur ndërsa tema gjithnjë e më shpesh hapet para publikut, mosbesimi institucional dhe reagimi i ngadaltë mbeten pengesa kryesore për luftimin efektiv të dhunës. Ata priren të besojnë në institucionet me të cilat kanë kontakte të drejtpërdrejta dhe të përditshme (arsimore dhe shëndetësore), si dhe në polici dhe qendrat për punë sociale, ndërsa gjyqësori dhe prokuroria perceptohen si joefikase, të paqasshme dhe joempatike.
3. Institucionet me besimin më të ulët njëherësh janë ato ku gratë e reja dhe vajzat i shohin lëshimet më të mëdha në punën e tyre përmes ndëshkimit përkatës të autorëve. Dobësia sistemike, ngathtësia dhe ndjeshmëria e pamjaftueshme e personave zyrtarë e zvogëlojnë vullnetin e viktimave ta raportojnë dhunën, me ç'rast mangësitë më të mëdha vërehen në ndëshkimin e autorëve, mbështetjen e viktimave dhe shpejtësinë e reagimit. Mungesa e personelit të sensibilizuar, mosharmonizimi midis institucioneve dhe kuadri i kufizuar ligjor në mënyrë plotësuese e komplikon problemin.
4. Gratë e reja dhe vajzat presin që institucionet të jenë më të qasshme, transparente dhe më senzitive ndaj nevojave të tyre, duke i marrë parasysh prioritetet kryesore

siç janë garancia e besueshmërisë, qasja e thjeshtë në shërbimet, mbështetja e specializuar dhe komunikimi i qartë dhe i drejtpërdrejtë sipas qasjes së bazuar në viktimën.

5. Organizatat qytetare gëzojnë besim më të madh dhe ofrojnë mbështetje psikologjike, ligjore dhe materiale (si strehimi dhe akomodimi i viktimave), megjithatë kapaciteti i tyre është i kufizuar, veçanërisht në mjediset rurale. Megjithatë, angazhimi i shtuar i organizatave qytetare, shembujt pozitivë nga shkollat dhe iniciativat për edukim dhe mbështetje përbëjnë bazë të rëndësishme për përmirësim.
6. Një numër i konsiderueshëm i grave të reja dhe vajzave kanë pasur përvojë direkte ose indirekte të dhunës që nga adoleshenca e tyre. Megjithëse shumica deklaruan se nuk kanë qenë viktimë, ekziston një probabilitet i madh i shfaqjes së nënvlerësuar të dhunës, veçanërisht në rastet e ngacmimit dhe abuzimit psikologjik, verbal dhe ekonomik. Gratë e reja dhe vajzat janë gjithnjë e më të ekspozuara ndaj formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit - veçanërisht dhunës psikologjike, verbale, ekonomike dhe digjitale, të cilat, edhe pse më të përhapura, mbeten më pak të identifikuar dhe të sanksionuara.
7. Pikëpamjet dhe normat patriarkale, niveli i ulët i informimit (njohurive) kontribuojnë në normalizimin dhe shpesh minimizimin e dhunës, veçanërisht brenda familjes dhe në marrëdhëniet e partnerëve.
8. Dhuna ndodh kudo, por shtëpia, rruga dhe hapësirat publike janë vendet më të rrezikshme ku gratë e reja përballen me forma të ndryshme të dhunës. Format e kontrollit të dhunshëm dhe format ekonomike të dhunshme janë më të përhapura në banesa ndërkaq në rrugë më të përhapura janë ngacmimi seksual dhe vëzhgimi, gjë që e konfirmon pasigurinë e grave në hapësirat publike. Shkollat dhe fakultetet janë vatra të dhunës psikologjike dhe verbale.
9. Frika, turpi dhe mosbesimi në institucione janë tre faktorët më të rëndësishëm që i pengojnë gratë e reja dhe vajzat të raportojnë dhunën me bazë gjinore. Informimi i pamjaftueshëm i procedurave dhe shërbimeve të qasshme janë faktorë shtesë që kontribuojnë në probabilitetin e ulët të raportimit të rasteve. Frika nga gjykimi, hakmarrja dhe stigma, së bashku me varësinë ekonomike dhe mungesën e mekanizmave të sigurt për raportimin anonim, i dekurajojnë viktimat të kërkojnë ndihmë.
10. Gratë e reja dhe vajzat kryesisht reagojnë përmes strategjive të shmangies dhe vetëmbrojtjes dhe jo përmes kanaleve institucionale. Gratë e reja dhe vajzat më së shumti reagojnë brenda rrjetit personal ose joformal të mbështetjes, ndërsa raportimi institucional dhe kërkesa e ndihmës janë të rralla.
11. Dhuna digjitale po bëhet një formë gjithnjë e më e shpeshtë dhe serioze e dhunës, e cila më së shumti i godet gratë e reja dhe vajzat. Format më të shpeshta të dhunës në hapësirën digjitale janë krijimi i profileve të rreme, komentet ofenduese dhe mesazhet e padëshiruara, ndërsa rrjetet sociale janë hapësira kryesore ku gratë e reja

dhe vajzat përjetojnë ose dëshmojnë dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin.

12. Kombinimi i anonimitetit, përhapjes së shpejtë dhe mosinformimit krijojnë një mjedis në të cilin dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi në hapësirën digjitale riprodhohet lehtësisht.
13. Raportimi i dhunës online është shumë i rrallë për shkak të mosbesimit në institucionet, informimit të pamjaftueshëm dhe identifikimit të dhunës, si dhe mekanizmave joefektivë të mbrojtjes.
14. Gratë e reja dhe vajzat presin një sistem të integruar të parandalimit dhe mbështetjes në rastet e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit në hapësirën digjitale, i cili përfshin reagimin institucional, rregulla të qarta për përdorimin e platformave, instrumente teknologjike për mbrojtje dhe edukim të vazhdueshëm.

Rekomandime

1. Krijimi i protokolleve të qarta për veprim, trajnim të personave zyrtarë dhe reagimi i shpejtë.
2. Rritja e sigurisë kërkon reagim të shpejtë dhe efikas institucional pas raportimit, mbështetje të vazhdueshme dhe forcimin e sistemeve të mbrojtjes dhe praninë e policisë në hapësirën publike.
3. Efikasitet dhe bashkëpunim multisektorial i institucioneve që do të sigurojnë një përgjigje më të shpejtë dhe më të koordinuar duke siguruar personel të trajnuar në çdo stacion policie, prokurori dhe qendrat për punë sociale për trajtimin të ndjeshëm dhe profesional të rasteve të dhunës, si dhe burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për shërbime funksionale siç janë strehimoret dhe ndihma dhe mbështetja psikologjike falas.
4. Mbështetje jashtë institucionale për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit duke mbështetur organizatat qytetare dhe qendrat rinore që punojnë me viktimat e dhunës.
5. Përfshirja e programeve për të punuar me kryerësit, të cilat do të mundësojnë risocializimin dhe reduktimin e rrezikut nga përsëritja e dhunës.
6. Programe arsimore të detyrueshme në shkollat: Përfshirja e edukimit për rolet gjinore, parandalimin e dhunës dhe edukimin seksual nga moshat e reja, duke përfshirë në mënyrë aktive prindërit për mbështetjen emocionale dhe praktike të fëmijëve dhe përmes integritetit të qasjeve që i përfshijnë në mënyrë aktive burrat dhe djemtë duke promovuar mashkulloritetin pozitiv, empatinë dhe respektin për barazinë gjinore.
7. Zhvillimi i programeve dhe aktiviteteve specifike për të rinjtë, të cilat do t'i udhëzojnë ata drejt angazhimit pozitiv dhe edukativ.

8. Programet edukative për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit, edukimin seksual, me përfshirjen aktive të prindërve.
9. Forcimi i ndërgjegjësimit publik përmes fushatave dhe shembujve pozitivë, me qëllim nxitjen e besimit midis viktimave dhe promovimin e kulturës së përgjegjësisë dhe tolerancës zero ndaj dhunës.
10. Gratë e reja dhe vajzat në mënyrë të vazhdueshme duhet të marrin edukim digjital. Përveç kësaj, të rinjtë duhet të marrin edukim të vazhdueshëm për raportimin e dhunës me bazë gjinore dhe keqpërdorimin e të dhënave personale. Ata duhet të njihen me rolin e institucioneve përgjegjëse si shkollat, policia dhe avokati i popullit si dhe me procedurën e raportimit të dhunës me bazë gjinore.
11. Platforma digjitale për mbështetje: Bashkimi i viktimave, profesionistëve dhe institucioneve në një vend, me mundësinë për të shkëmbyer përvoja, informacione për burimet dhe këshilla praktike, duke përfshirë edhe opsione anonime për mbrojtjen dhe motivimin e viktimave. Zgjerimi i përpjekjeve për informim dhe edukim përmes kanaleve të përshtatura për të rinjtë, duke përfshirë aplikacione mobile dhe platforma të mediave sociale, për përfshirjen në mënyrë efektive të të rinjve në parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

METODOLOGJIA DHE VËLLIMI I HULUMTIMIT



Qëllimi i hulumtimi

Qëllimet kryesore të hulumtimit janë:

- ▶ Shqyrtimi i prevalencës dhe formave të ndryshme të dhunës ndaj grave të reja dhe vajzave të moshës 18-29 vjeç në jetën publike, si në onlajn ashtu edhe në oflajn.
- ▶ Hulumtimi i mënyrës se si dhuna manifestohet në mjedise të ndryshme, duke përfshirë institucionet arsimore, vendet e punës, hapësirat publike, mjediset sociale dhe platformat digjitale.
- ▶ Hulumtimi se si identitetet në fjalë, duke e përfshirë përkatësinë etnike (p.sh. te romet), aftësinë e kufizuar, vendbanimin (urban/rural) dhe statusin socio-ekonomik, ndikojnë në natyrën dhe intensitetin e dhunës.
- ▶ Identifikoni pengesat e qasjes në mbrojtje dhe drejtësi, duke i përfshirë arsyet e raportimit të pamjaftueshëm, frikën nga hakmarrja, viktimizimin e serishëm, mosbesimin ndaj institucioneve dhe mungesën e shërbimeve të qasshme, miqësore për mbështetjen e të rinjve dhe cilësinë e mbështetjes institucionale.
- ▶ Analizimi i faktorëve kryesorë që kontribuojnë në dhunën me bazë gjinore, duke përfshirë normat e dëmshme gjinore, stereotipat gjinorë që ndikojnë në dhunën me bazë gjinore, boshllëqet në mbrojtjen institucionale dhe ligjore, mjedisi online që mundëson ngacmimin dhe abuzimin, dhe qasjen e kufizuar në burime, informacione ose mundësi që e zvogëlojnë aftësinë e tyre për të kërkuar mbështetje ose për të ndërmarrë veprime.
- ▶ Mekanizmat e luftimit të viktimave të dhunës me bazë gjinore (konstruktive ose potencialisht të dëmshme).

Metodologjia e hulumtimit

Hulumtimi kuantitativ

Grupi i synuar i këtij hulumtimi ishin gratë e reja dhe vajzat të moshës 18-29 vjeç nga Republika e Maqedonisë së Veriut. Për qëllimet e këtij hulumtimi, u zhvillua një model reprezentativ duke përdorur modele të stratifikuara me shumë nivele me një probabilitet proporcional të madhësisë së vlerësuar të popullsisë. Para përzgjedhjes së modelit, njësitë e modelit u shpërndanë nëpër stratumet sipas proporcioneve të popullatës së përfshirë me hulumtimin. Kështu, u siguroi një model reprezentativ i strukturës së popullsisë së synuar, për sa i përket përkatësisë etnike, seksit, grup moshës, vendbanimit (urban/rural) dhe rajonit statistikor.

Në model u përfshin gjithsej 600 të anketuara ndërsa gabimi i modelit është 3.94% me një nivel besimi prej 95%¹.

Zhvillimi i intervistave me të anketuarat u bë përmes një interviste ballë për ballë të asistuar nga kompjuteri me të anketuarën në banesën e saj. Intervistat u zhvilluan në gjuhën maqedonase ose shqipe.

Hulumtimi kualitativ

Në kuadër të hulumtimit kualitativ, u organizuan katër (4) diskutime në grupe fokus me përfaqësues dhe përfaqësuese të organizatave qytetare dhe Këshillit Rinor të Presidentes të Maqedonisë së Veriut. Modeli i grupeve fokus ishte i përbërë nga gjithsej 24 pjesëmarrës/se, të shpërndarë në katër grupe, që i përfaqësojnë organizatat qytetare që punojnë në tema që lidhen me aktivitetet rinore, arsimin dhe mbrojtjen nga DHBGJ dhe dhuna në familje. Pjesëmarrësit/et përfaqësuan shtatë organizata të ndryshme, si më poshtë: (1) Këshilli Rinor, (2) Unioni i Nxënësve të Shkollave të Mesme, (3) NECI - Rrjeti për Qytetari dhe Identitet Evropian në Maqedoninë e Veriut, (4) Stela, (5) Shoqata Humanitare Nëna Kumanovë, (6) Rrjeti Kombëtar Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje dhe (7) Qendra Korteks.

¹ Gabimi i modelit u përllogarit me formulën $E = 1.96 \times \sqrt{p(1-p)/n}$, ku për $p = 0.5$ dhe $n = 600$ është $\pm 3.94\%$ në një nivel besimi prej 95%.

Rezultatet

Analiza bazohet në gjetjet e mbledhura përmes sondazhit dhe grupeve fokus me gra të reja dhe vajza të moshës prej 18 deri në 29 vjeç. Kjo pjesë ofron një pasqyrë të gjetjeve sipas fushave, duke e/i përfshirë:

- ▶ Perceptimin dhe pikëpamjet në lidhje me dhunën me bazë gjinore dhe kontekstin institucional
- ▶ Format dhe përhapjen e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin
- ▶ Mjedisin online dhe dhunën digjitale

Perceptimi dhe pikëpamjet lidhur me DHBGJ dhe konteksti institucional


Vlerësimi i situatës së sigurisë

Grave të reja dhe vajzave iu kërkua të vlerësonin sigurinë në hapësirën publike, përkatësisht të vlerësonin sa shpesh janë ndjerë të pasigurta në hapësirën publike si grua apo vajzë. Tre nga katër të anketuarat, përkatësisht (74%) janë ndjerë të pasigurta në një hapësirë publike për shkak të të qenit grua ose vajzë, përkatësisht vetëm 27% deklaruan se kurrë nuk ishin ndjerë të pasigurta në një hapësirë publike për shkak të seksit të tyre.

Grafiku 1:

Ndjenja e sigurisë në hapësirën publike

Sa shpesh jeni ndjerë të pasigurta në hapësirën publike për shkak të të qenit grua ose vajzë



Gjetjet sipas grup moshave nuk tregojnë dallime të rëndësishme në kuptimin e sigurisë të nëngrupet e ndryshme të grave të reja dhe vajzave. Megjithatë gratë e reja dhe vajzat nga mjediset urbane u deklaruan në një përqindje pak më të lartë që ndonjëherë ose rrallë janë ndjerë të pasigurta, në krahasim me gratë e reja dhe vajzat nga mjediset rurale, megjithatë nuk ekziston ndonjë ndryshim i rëndësishëm statistikor në ndjenjën e sigurisë midis dy nëngrupeve të grave të reja dhe vajzave.

Nga aspekti i përkatësisë etnike gratë e reja dhe vajzat shqiptare në një përqindje dukshëm më të lartë (90%) janë ndjerë të paktën në një moment të pasigurta në hapësirën publike në krahasim me gratë e reja dhe vajzat maqedonase (66%), gratë e reja dhe vajzat rome (77%) dhe pjesëtarët e komuniteteve të tjera etnike (74%).


Dallime të konsiderueshme në ndjenjën e sigurisë janë shfaqur midis të anketuarave që vijnë nga familje me status më të ulët ekonomik (siç matet nga të ardhurat mujore të familjes) krahasuar me ato që vijnë nga familje me status më të lartë ekonomik. Me fjalë të tjera, në grupin e parë të grave të reja dhe vajzave, ndjenja e pasigurisë në hapësirën publike u shfaq në 9 nga 10 të anketuara (88%) krahasuar me 67% të grave të reja dhe vajzave nga familje me të ardhura të larta që janë ndjerë të pasigurta në hapësirën publike.

E lidhur ngushtë me ndjenjën e sigurisë në hapësirën publike është edhe nëse një ndjenjë e tillë ndonjëherë i ka detyruar gratë e reja dhe vajzat t'i shmangen ndonjë aktiviteti për shkak të frikës nga dhuna. Çdo e katërta grua e re dhe vajzë (27%) deklaruan se nga moshë 15 vjeç i janë shmangur ndonjë aktiviteti ose vendi për shkak të frikës nga dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi. Shqetëson fakti se një nga katër të anketuara (25%) është përgjigjur se nuk mban mend nëse ka shmangur ndonjë aktivitet ose vend për shkak të frikës nga dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi.

Grafiku 2:

Aktiviteti/vendi i shmangur
për shkak të frikës nga
DHBGJ

**A keni ikur
ndonjëherë (nga
mosha 15 vjeç) nga
ndonjë aktivitet ose
vend për shkak të
frikës nga dhuna me
bazë gjinore dhe/ose
ngacmimi ?**



Duke e perceptuar sipas grup moshave, gratë e reja dhe vajzat e moshës 18 deri në 21 vjeç në një përqindje dukshëm më të lartë (32%) deklarojnë se i janë shmangur ndonjë aktiviteti ose vendi nga frika e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit në krahasim me ato të moshës 26 deri në 29 vjeç (22%). Analiza e rezultateve sipas përkatësisë etnike të të anketuarave vë në dukje se madje 57% rome i janë shmangur ndonjë aktiviteti ose vendi për shkak të frikës nga dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit krahasuar me një përqindje dukshëm më të ulët të maqedonaseve (24%), shqiptareve (31%) dhe anëtarëve të grupeve të tjera etnike (21%).

Analiza e mëtejshme e të dhënave vë në dukje se grupe të caktuara të grave të reja dhe vajzave kanë më shumë gjasa t'i shmangen ndonjë aktiviteti ose vendi për shkak të frikës nga e DHBGJ dhe/ose ngacmimit. Këto grupe përfshijnë:

- ▶ Gra të reja dhe vajza që vijnë nga familje me status më të ulët ekonomik (me të ardhura familjare deri në 24 mijë denarë) - 43%,
- ▶ Gra të reja dhe vajza pa arsim formal (ose me arsim fillor) (49%),
- ▶ Gra të reja dhe vajza nga rajoni verilindor (42%), rajoni juglindor (38%) dhe rajoni i Vardarit (35%).

Puna e institucioneve në mbrojtje nga DHBGJ


Sipas rezultateve të hulumtimit kuantitativ për sa i përket besimit në institucionet kur bëhet fjalë për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi, gratë e reja dhe vajzat kanë besim më të madh në institucionet arsimore (67%) dhe shëndetësore (62%), pasuar nga policia (55%), qendrat për punë sociale (51%) dhe organizatat qytetare (50%).

Nga ana tjetër, gratë e reja dhe vajzat kanë besim më të ulët në gjykatat - 27% e të anketuarave deklaruan se nuk kanë aspak besim në këtë institucion dhe në prokurorinë publike - 20% deklaruan se nuk kanë besim në këtë institucion.

Grafiku 3:

Besimi në institucionet

Deri në cilën shkallë keni besim në institucionet dhe organizatat e mëposhtme (, ,) kur bëhet fjalë për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore ose ngacmimi?



Gjetjet e hulumtimit kualitativ vënë në dukje se besimi në institucionet është shumë i ulët, përkatësisht pothuajse inekzistent. Sipas mendimit të pjesëmarrësve/eve në diskutimet në grupe, mosbesimi në përgjithësi buron nga rastet e shpeshta të reagimeve joefektive, procedurave të gjata dhe mbrojtjes së pamjaftueshme të viktimave, gjë që krijon ndjenjën se raportimi nuk ka efekt real. Për më tepër, viktimat shpesh zgjedhin të mbeten anonime ose të mos raportojnë fare për shkak të frikës nga gjykimi, turpit dhe pasojave të mundshme të dhunuesit. Mungesa e stafit të ekspertëve dhe stafit të sensibilizuar në mënyrë plotësuese e përkeqëson situatën, meqë institucionet shpesh veprojnë formalisht, pa empati dhe mirëkuptim.


Institucionet kryesore për luftimin e DHBGJ

Policia dhe qendrat për punë sociale duhet të luajnë një rol kryesor në luftimin e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit sipas mendimit të grave të reja dhe vajzave. Përkatësisht, 69% e të anketuarave e kanë theksuar policinë si një institucion kryesor në luftimin e DHBGJ dhe/ose ngacmimit, pasuar nga 61% e të anketuarave që i kanë theksuar qendrat për punë sociale. Sa i përket përqindjes së institucionit të theksuar të parë, këto dy institucione - policia dhe qendrat për punë sociale kanë përqindje më të lartë përkatësisht 31% dhe 22% të përgjigjeve.

Grafiku 4:

Roli kryesor në luftimin e DHBGJ

Cilat institucione dhe/ose organizata mendoni se duhet të kenë një rol kryesor në luftimin e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit?



Mendimi se cilat institucione duhet të kenë një rol kryesor në luftimin e DHBGJ dhe/ose ngacmimit ndryshon varësisht nga grupet e ndryshme të grave të reja dhe vajzave, të cilat konsiderojnë se:

- ▶ Gratë e reja dhe vajzat nga mjediset rurale në një përqindje më të madhe (20%) mendojnë se institucionet shëndetësore duhet të kenë një rol kryesor në krahasim me të anketuarat nga mjediset urbane (11%), të cilat nga ana e tyre mendojnë se institucionet arsimore duhet ta kenë rolin kryesor (27%) krahasuar me 19% të të anketuarave në mjediset rurale që e ndajnë këtë mendim.

- ▶ Pothuajse të gjitha të anketuarat rome (97%) e theksuan policinë si një institucion që duhet ta ketë rolin kryesor në luftimin e DHBGJ dhe /ose ngacmimit, që është një përqindje dukshëm më e lartë në krahasim me përqindjen e pjesëtareve të bashkësive të tjera etnike. Gratë e reja dhe vajzat shqiptare në një përqindje më të lartë rëndësi më të madhe i japin vetëqeverisjes lokale (20%) në luftimin e DHBGJ krahasuar me maqedonaset (9%), të cilat nga ana e tyre mendojnë se qendrat e punës sociale duhet të kenë një rol kryesor (65%) krahasuar me 54% të shqiptareve që e ndajnë të njëjtin mendim.
- ▶ Gratë e reja dhe vajzat me arsim të lartë në një përqindje prej (19%) mendojnë se organizatat qytetare duhet të luajnë një rol kryesor, krahasuar me vetëm 3% të grave të reja dhe vajzave të cilat në kuadër të modelit integral të të anketuarave e ndajnë këtë mendim.

Roli i policisë si një institucion kryesor shtetëror sa i përket luftimit të dhunës me bazë gjinore u potencua edhe në diskutimet në grupe të hulumtimit kualitativ. Megjithatë, sipas njohurive të pjesëmarrësve/eve, roli i policisë në praktikë është shumë i dobët dhe pothuajse i padukshëm, që do të thotë se policia reagon më shpesh madje kur situata bëhet alarmante ose kur tanimë ka ndodhur një tragjedi, ndërsa aktivitetet parandaluese mungojnë pothuajse tërësisht. Përveç policisë, u theksua edhe rëndësia e qendrave për punë sociale, gjykatave dhe prokurorive publike. Institucionet shëndetësore - veçanërisht mjekët e familjes dhe shërbimet psikologjike - u apostrofuan nga pjesëmarrësit/et në grupet fokus si institucione të para që mund t'i identifikojnë shenjat e dhunës.


Sa i përket parandalimit, pjesëmarrësit-et theksuan se shkollat dhe universitetet duhet të luajnë një rol më të madh përmes përfshirjes së programeve edukative dhe arsimore që do të rrisin ndërgjegjësimin dhe njohuritë e të rinjve rreth asaj se çfarë është dhuna dhe si të reagojnë. Sipas disa pjesëmarrësve/eve, praktika të tilla ekzistojnë tashmë në shkolla të caktuara dhe janë vlerësuar si shembull pozitiv që duhet të zgjerohet dhe sistematizohet.

Kur bëhet fjalë për reagimin e institucioneve në parandalimin dhe ndëshkimin e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit ndaj grave të reja dhe vajzave, mendimet e të anketuarave janë të ndara. Konkretisht, 51% e të anketuarave mendojnë se institucionet reagojnë plotësisht ose pjesërisht në mënyrë adekuate për parandalimin dhe ndëshkimin e DHBGJ, ndërsa 40% e të anketuarave nuk e ndajnë këtë mendim, që është një përqindje jashtëzakonisht e lartë.

Grafiku 5:

Reagimi i duhur i institucioneve

A mendoni se institucionet tona reagojnë në mënyrë të duhur kur bëhet fjalë për parandalimin dhe ndëshkimin e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit ndaj grave të reja ose vajzave?



Analiza e të dhënave mbi këtë pyetje vë në dukje se një përqindje dukshëm më e lartë e të anketuarave që mendojnë se institucionet nuk reagojnë në mënyrë adekuate kur bëhet fjalë për parandalimin dhe ndëshkimin e DHBGJ dhe/ose ngacmimit ndaj grave të reja ose vajzave janë në mesin e atyre pa arsim formal dhe fillor, romeve dhe të anketuarave që kanë një status më të lartë ekonomik, përkatësisht vijnë nga familje me të ardhura më të larta mujore familjare.

Gjetjet nga hulumtimi kualitativ vënë në dukje se ajo që mungon më së shumti në veprimet e institucioneve është reagim i shpejtë dhe në kohë, si dhe qasja serioze dhe e ndjeshme ndaj viktimave. Pjesëmarrësit/et theksojnë se shumë gra mendojnë se institucionet nuk e perceptojnë situatën e dhunshme si një problem serioz, gjë që e rrënon besimin e tyre dhe i inkurajon ta fshehin dhunën ose të mos e raportojnë.

Mungon edhe koordinimi midis institucioneve - policia, gjykatat, prokuroria publike dhe qendrat për punë sociale shpesh nuk i shkëmbejnë informacione në kohën e duhur, çështjet prolongohen ose neglizhohen, kurse viktimat lihen vetëm, pa mbështetje psikologjike, sociale ose financiare. Mungesa e shërbimeve dhe burimeve të specializuara në mënyrë plotësuese e përkeqëson situatën, duke i lënë viktimat të cenueshme dhe pa mbrojtje adekuate.

Njohuritë në lidhje me DHBGJ


Shumica e grave të reja dhe vajzave (71%) kanë informacione të mjaftueshme ose të pjesshme për të identifikuar dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin. Megjithatë, çdo e katërta grua e re ose vajzë (27%) deklaron se nuk ka informacione të mjaftueshme për të identifikuar dhe kërkuar mbrojtje nga DHBGJ.

Sipas pjesëmarrësve/eve në diskutimet në grupe, shumë vajza nuk janë të vetëdijshme se janë viktima të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit, veçanërisht kur bëhet fjalë për format psikologjike ose ekonomike - sjellje kontrolluese, xheloz, kufizimi i financave ose i lirisë personale. Ky lloj dhune me bazë gjinore dhe/ose ngacmim shpesh fshihet nën maskën e “dashurisë”, “kujdesit” ose “sjelljes normale” në një lidhje, duke çuar në krijimin e marrëdhënieve toksike në të cilat gratë e reja dhe vajzat e humbasin gradualisht vetëbesimin dhe aftësinë e identifikimit se po abuzohen.

Grafiku 6:

Informacione për DHBGJ

A mendoni se keni informacione të mjaftueshme për të identifikuar dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin dhe të kërkonti mbrojtje?




Përqindja e grave të reja dhe vajzave që nuk kanë informacione të mjaftueshme rreth dhunës me bazë gjinore dhe si të kërkojnë mbrojtje është veçanërisht shqetësuese të romet (47%), si dhe tek ato pa arsim formal (50%) ose me arsim fillor (49%).

Sipas mendimit të të anketuarave, frika, mosbesimi tek institucionet dhe turpi më së shpeshti apostrofohen si arsye pse dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi nuk raportohet.

Grafiku 7:

Arsyet për mos raportimin e DHBGJ

Cilat janë arsyet më të shpeshta pse dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi nuk raportohet?



Kjo u konfirmua edhe me hulumtimin kualitativ, ku arsyet kryesore pse gratë e reja dhe vajzat nuk e raportojnë dhunën me bazë gjinore janë frika, turpi dhe mosbesimi ndaj institucioneve. Frika nga hakmarrja, gjykimi nga mjedisi dhe mundësia që dhunuesi të zbulojë se viktima e ka raportuar e rrit pasigurinë dhe rrezikun. Turpi, faji dhe frika nga stigma publike i çojnë viktimat të heshtin. Mosbesimi ndaj institucioneve dhe bindja se raportimi nuk do të sjellë mbrojtje ose ndëshkim i dekurajon në mënyrë plotësuese. Varësia ekonomike është gjithashtu një faktor i rëndësishëm - shumë gra të reja dhe vajza nuk kanë ku të shkojnë ose nuk kanë mjete për t'u bërë të pavarura. E gjithë kjo krijon një rreth heshtjeje, i cili mund të thyhet vetëm nga besimi më i madh në sistem, mbrojtja efektive dhe ndryshimi i qëndrimeve shoqërore ndaj viktimave.

Megjithëse arsyet e tjera janë theksuar në një përqindje më të vogël nga gratë e reja dhe vajzat, arsye të caktuara janë theksuar në një përqindje dukshëm më të lartë te grupe të caktuara.


- ▶ Presioni familjar theksohet në një përqindje dukshëm më të lartë nga romet (53%) krahasuar me përqindjen e përgjithshme të theksuar te popullata e synuar (25%).
- ▶ Informimi i pamjaftueshëm se ku të raportohet theksohet si arsye në një përqindje dukshëm më të lartë midis romeve (37%) dhe pjesëtareve të grupeve të tjera më të vogla etnike (36%).
- ▶ Sa i përket statusit arsimor, turpi si shkak paraqitet në një përqindje dukshëm më të lartë (66%) te gratë e reja dhe vajzat me arsim fillor në krahasim me të anketuarat me arsim të lartë.
- ▶ Mungesa e qasjes në mbështetjen falas, theksohet si arsye në një përqindje dukshëm më të lartë (31%) nga të anketuarat me arsim të lartë.

Ndërgjegjësimi për ekzistimin dhe qasshmërinë e shërbimeve rinore dhe senzitive gjinore për mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit është në një nivel relativisht të ulët. Gjysma e grave të reja dhe vajzave mendojnë se nuk ekzistojnë (30%) ose nuk e dinë se ekzistojnë (21%), përkatësisht nuk mund të vlerësojnë. Vetëm 7% e grave të reja dhe vajzave e dinë se shërbime të tilla ekzistojnë dhe mendojnë se janë të qasshme, ndërsa 42% deklaruan se janë të vetëdijshme se ekzistojnë, por mendojnë se nuk janë mjaft të qasshme.

Grafiku 8:

Ndërgjegjësimi për
ekzistimin e shërbimeve

**A mendoni se
ekzistojnë shërbime
të qasshme,
shërbime rinore dhe
të ndjeshme gjinore
për mbështetjen e
viktimave të dhunës
me bazë gjinore dhe/
ose ngacmimit?**



Veçanërisht i ulët është ndërgjegjësimi për ekzistimin dhe qasshmërinë e shërbimeve të tilla në grup moshën (prej 18 deri në 21 vjeç) dhe te romet. Për sa i përket statusit arsimor, gratë e reja dhe vajzat pa arsim formal ose me arsim fillor në një përqindje dukshëm më të lartë deklarojnë se nuk janë në dijeni për ekzistimin e shërbimeve rinore dhe shërbimeve të ndjeshme gjinore për mbështetjen e viktimave nga dhuna me bazë gjinore dhe/ose dhuna.

Në këtë drejtim, mendimi i pjesëmarrësve/eve në diskutimet në grupe konsiston me atë se organizatat qytetare duhet të kenë një rol edhe në ofrimin e ndihmës praktike - mbështetje psikologjike, shërbimi këshillimor ligjor, strehime dhe programe arsimore - veçanërisht aty ku shteti nuk ka kapacitete. Vetëm përmes mbështetjes së vazhdueshme, rezultateve të dukshme publikisht dhe punës së koordinuar me institucionet mund të krijohet një ndjenjë sigurie midis viktimave dhe të inkurajohen të raportojnë, duke e ditur se ata nuk do të lihen të vetëm në atë proces.


Pikëpamjet lidhur me DHBGJ

Në sondazhin, gratë e reja dhe vajzat u pyetën se në çfarë mase pajtohen ose jo, me një seri deklaratash në lidhje me rolet gjinore dhe ndërveprimet midis burrave dhe grave. Për sa i përket pikëpamjeve themelore në lidhje me dhunën me bazë gjinore, shumica e grave të reja dhe vajzave nuk pajtohen (61%) me pikëpamjet se dhuna në familje është një çështje private dhe duhet të mbetet në familje, se dhuna shkaktohet nga vetë viktimat (67%) dhe se gratë shpikin ose ekzagjerojnë me pohimet për abuzim (65%). Mendimet nëse gratë përdhunohen më shpesh nga persona të panjohur sesa nga personat që i njohin janë të ndara. Gjegjësisht, 27% e të anketuarave pajtohen me këtë deklaram, ndërsa 34% nuk pajtohen.

Grafiku 9:

Pikëpamjet themelore të DHBGJ

Sa pajtoheni me deklaratat e mëposhtme, ku 1 do të thotë 'aspak nuk pajtohem' ndërsa 5 do të thotë 'plotësisht pajtohem'?



■ Plotësisht pajtohem /
Deri diku pajtohem

■ Aspak nuk pajtohem / Deri
dikui nuk pajtohem

Megjithëse shkalla e pajtimit me këto deklarata është relativisht e ulët, ekzistojnë grupe të caktuara të grave të reja dhe vajzave ku këto stereotipa negativë janë më të theksuar. Se dhuna në familje është një çështje private dhe duhet të zgjidhet brenda familjes është një mendim që është më i përhapur në mesin e grave të reja dhe vajzave shqiptare dhe rome, grave të reja dhe vajzave që janë përkohësisht/joformalisht të punësuar ose janë të papunësuar, dhe në mesin e të anketuarave që vijnë nga familje me status më të ulët ekonomik, përkatësisht me të ardhura mujore familjare deri në 30,000 denarë. Mendimi se dhuna shpesh shkaktohet nga vetë viktimat, më shumë sesa mesatarja mbizotëron midis të anketuarave me përkatësi etnike shqiptare, dhe në mesin e atyre që janë të punësuar përkohësisht/joformalisht dhe të papunësuar me të ardhura familjare deri në 24,000 denarë.

Me deklarin se gratë dhe vajzat që deklarojnë se abuzohen shpesh i ekzagjerojnë pretendimet, në një përqindje dukshëm më të lartë pajtohen të anketuarat nga mjediset rurale (14%), pa arsim formal (17%) dhe të papunësuar (16%) ose përkohësisht/joformalisht të punësuar (15%) me të ardhura familjare deri në 24,000 denarë (30%).

Të dhënat vënë në dukje se besimet sa i përket nënshtrimit dhe skllavërisë së grave janë të nën-përfaqësuar në mesin e grave të reja dhe vajzave të përfshira me hulumtimin. Pjesa më e madhe e grave të reja dhe vajzave të anketuara nuk pajtohen me deklarin se është detyrim i gruas ose partneres të ketë marrëdhënie seksuale me partnerin e saj madje edhe atëherë kur ajo nuk dëshiron (80%), dhe se është e rëndësishme që burri t'i tregojë partneres së tij se kush është kryesori në atë lidhje (75%).

Një shkallë dukshëm më e lartë e pajtimit midis grave të reja dhe vajzave gjendet në deklaratat që e normalizojnë dhunën ndërsa fajin ia kalojnë viktimës:


- ▶ 31% e të anketuarave pajtohen me deklaratën se vajzat që vishen në mënyrë provokatore tërheqin sjellje të dhunshme,
- ▶ Çdo e katërta grua e re ose vajzë (24%) pajtohet me deklaratën se nëse vajza kundërshton ose mbrohet kjo gjë vetëm e përkeqëson sjelljen e partnerit,
- ▶ Një në pesë të anketuara (20%) pajtohet me deklaratën se një koment i padëshiruar me konotacion seksual nuk është ngacmim seksual.

Së fundi, shumica e grave të reja dhe vajzave (66%) pajtohen që njerëzit e tjerë jashtë familjes duhet të intervenojnë nëse partneri është i dhunshëm ndaj partneres së tij, si dhe me të drejtën e një gruaje për të zgjedhur miq edhe nëse partneri i saj nuk pajtohet me atë zgjedhje (71%).

Grafiku 10:

Normat dhe sjelljet e pranueshme

Sa pajtoheni me deklaratat e mëposhtme, ku 1 do të thotë 'aspak nuk pajtohem' ndërsa 5 do të thotë 'plotësisht pajtohem'?




Në seksionin e fundit ku shqyrtohen pikëpamjet e ndryshme të grave të reja dhe vajzave ndaj dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit, i shqyrtojmë perceptimet e cënueshmërisë së grave të reja dhe vajzave dhe grupeve të ndryshme në rrezik ndaj dhunës. Të gjithë faktorët (statusi, përkatësia, aftësia e kufizuar, vendbanimi) konsiderohen të rëndësishëm në perceptimin e rrezikut të dhunës me bazë gjinore. Megjithatë, statusi socio-ekonomik është faktori më i identifikuar, si në aspektin e ekspozimit ashtu edhe të trajtimit. Thuaja se gjysma e të anketuarave pajtohen me deklaratat se vajzat dhe gratë e reja me status më të ulët socio-ekonomik janë më të ekspozuara ndaj dhunës me bazë gjinore dhe /ose ngacmimit (46%) dhe se statusi socio-ekonomik ndikon në mënyrën se si trajtohen kur janë viktimat të dhunës me bazë gjinore (46%).

Sipas pikëpamjeve të shprehura, përkatësia etnike ndikon gjithashtu në rrezikun dhe trajtimin e viktimave të dhunës me bazë gjinore - 42% e të anketuarave pajtohen me deklaratën se vajzat dhe gratë e reja nga grupe të caktuara etnike janë më të ekspozuara ndaj rrezikut nga dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit dhe 37% pajtohen me deklaratën se përkatësia etnike ndikon mbi mënyrën se si trajtohen viktimat e dhunës.

Grafiku 11:

Pikëpamjet ndaj grupeve në rrezik të grave të reja dhe/ose vajzave

Sa pajtoheni me deklaratat e mëposhtme, ku 1 do të thotë 'aspak nuk pajtohem' ndërsa 5 do të thotë 'plotësisht pajtohem'?



Plotësisht pajtohem / Deri diku pajtohem

Aspak nuk pajtohem / Deri dikui nuk pajtohem

Gratë e reja dhe vajzat me aftësi të kufizuara kanë më shumë gjasa të ekspozohen në rrezik të dhunës me bazë gjinore - kjo është një pikëpamje me të cilën pajtohen 41% e të anketuarave. Një përqindje relativisht e lartë e mospajtimit vë në dukje se ekzistojnë edhe mendime të ndryshme për çështje të caktuara. Për shembull, 28% nuk pajtohen që gratë e reja dhe vajzat nga mjediset rurale janë më shumë të ekspozuara ndaj rrezikut nga dhuna me bazë gjinore, ndërsa 37% e mendojnë të kundërtën, përkatësisht se ky grup i grave të reja dhe vajzave ka më shumë të ngjarë të ekspozohet në rrezik nga dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi.

Format dhe përhapja e DHBGJ dhe/ose ngacmimit


Problemet më të mëdha

Problemet financiare përkatësisht paqëndrueshmëria ekonomike është problemi më i theksuar me të cilin përballen gratë e reja dhe vajzat - çdo e katërta e anketuar (23%) e theksojnë këtë problem si të parin e theksuar dhe njëherësh është një problem i theksuar nga 30% e grave të reja dhe vajzave të intervistuar. Menjëherë pas këtij problemi, problemi i dytë është ndjenja e pasigurisë në hapësirën publike - 16% e theksojnë këtë problem, pasuar nga problemet që kanë të bëjnë me shëndetin mendor dhe ndjenja e pasigurisë në hapësirën online - probleme të theksuara nga 12% e grave të reja dhe vajzave .

Grafiku 12:

Problemet më të mëdha

Cili është problemi më i madh me të cilin ballafaqoheni aktualisht?



 Gjithsej i përmendur

 I përmenduri i parë

Analiza sipas karakteristikave demografike vë në dukje se grupe të caktuara të grave të reja dhe vajzave janë më të prekura nga probleme të caktuara:

- ▶ Sipas pritshmërive problemet financiare dhe paqëndrueshmëria ekonomike janë theksuar si probleme më të madha me të cilat ballafaqohen gratë e reja dhe vajzat të punësuara përkohësisht/të punësuar në mënyrë joformale (41%), si dhe të papunësuarat (37%). Për sa i përket përkatësisë etnike, gratë e reja dhe vajzat të përkatësisë etnike rome në një përqindje dukshëm më të lartë (60%) e theksojnë këtë problem si problemin më të madh me të cilin ballafaqohen.
- ▶ Problemet e shëndetit mendor theksohen më shpesh nga gratë e reja dhe vajzat të moshës 22 deri në 25 vjeç (17%), ndërsa ndjenja e pasigurisë në hapësirën onlajn, të tilla si ngacmimi onlajn, bulingu kibernetik është dukshëm më i theksuar (16%) midis vajzave më të reja të intervistuarat të moshës 18 deri në 21 vjeç.
- ▶ Megjithëse ndjenja e pasigurisë në banesë theksohet në një përqindje mjaft të vogël të rasteve (5%), ky problem theksohet me dyfishin e përqindjes (10%) të të anketuarave të grave të reja dhe vajzave të përkatësisë etnike rome dhe shqiptare.
- ▶ Diskriminimi si problem është veçanërisht i rëndësishëm në mesin e grave të reja dhe vajzave në mjediset rurale që e kanë theksuar në 13% të rasteve, krahasuar me vetëm 8% problemin e theksuar në mesin e grave të reja dhe vajzave në mjediset urbane.


Ndjenja e sigurisë në hapësirën publike

Grave të reja dhe vajzave iu kërkua të zgjidhnin se sa të sigurta ndihen në vende të ndryshme në hapësirat publike. Gjetja e përgjithshme konsiston me atë se gratë e reja dhe vajzat ndihen më pak të sigurta në vende më të mëdha dhe virtuale (siç është hapësira digjitale). Kështu, 44% e grave të reja dhe vajzave ndihen të pasigurta në hapësirën digjitale, pasuar nga 37% që ndjehen të pasigurta në vende publike si sheshe, parqe dhe rrugë, ndërsa 34% të cilat nuk ndjehen të sigurta në transportin publik. Nga ana tjetër, 89% e grave të reja dhe vajzave ndihen të sigurta në fqinjësinë e tyre kurse 79% në qytetin/fshatin e tyre dhe në institucionet arsimore.

Grafiku 13:

Ndjenja e sigurisë

Deri në çfarë mase ndiheni e sigurt si grua/ vajzë...



Prevalenca e dhunës

Dhuna ndaj të rinjve është një nga shqetësimet kryesore jo vetëm në Maqedoninë e Veriut, por edhe në vendet e Ballkanit Perëndimor dhe në nivelin ndërkombëtar. Dhuna në kontekstin kombëtar është përkufizuar në kuadër të strategjisë kombëtare si: “të gjitha llojet e dhunës fizike ose mendore, lëndimit ose abuzimit, neglizhencës ose sjelljes së pakujdesshme, keqtrajtimit ose eksploatimit të fëmijës, përfshirë këtu edhe abuzimin seksual.”². Në pjesën tjetër, dhuna do të analizohet në përgjithësi duke i përdorur rezultatet e studimit hulumtues.

² Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Drejtësinë e Fëmijëve në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2022 - 2027) dhe Plani i Veprimit (2022 - 2023) të aksesshme në: <http://dspdp.com.mk/vesti/promocija-nacionalnata-strategjia-za-prevenција-i-pravda-za-decata-2022-2027/>

Sipas rezultateve të hulumtimit, 34% e të anketuarave deklaruan se kishin përjetuar një lloj dhune me bazë gjinore, ndërsa 43% deklaruan se kishin qenë dëshmitare të dhunës me bazë gjinore. Rezultatet tregojnë se format më të përhapura të dhunës janë dhuna verbale dhe psikologjike, ndërsa dhuna seksuale dhe ngacmimi seksual janë më pak të raportuara. Shumica e të anketuarave (33%) deklaruan se kishin qenë dëshmitare të dhunës verbale kurse 24% se e kishin përjetuar personalisht. Pason dhuna psikologjike, me 24% dëshmitare dhe 16% viktimat të drejtpërdrejta. Këto të dhëna vënë në dukje se format e tilla të dhunës janë më të shpeshta, por edhe më të normalizuara në komunikimin e përditshëm. Gratë e reja dhe vajzat shpesh nuk i identifikojnë fyerjet verbale, poshtërimit ose manipulimin si dhunë, gjë që e vë në dukje nevojën për ndërgjegjësim më të madh për format emocionale të abuzimit.

Dhuna fizike është raportuar nga 12% viktimat dhe 22% dëshmitarë, gjë që tregon se ky lloj i dhunës është i njohur, por megjithatë i nënshtrohet mos-raportimit, veçanërisht kur bëhet fjalë për forma më të buta.

Te të anketuarat u vërejtën sjellje kontrolluese nga partneri, 13% si dëshmitare dhe 7% si viktimat. Ky rezultat vë në dukje ekzistencën e modeleve kontrolluese dhe manipuluese të sjelljes në marrëdhëniet intime, të cilat jo gjithmonë identifikohen si dhunë.

Dhuna ekonomike përfaqësohet në mënyrë të barabartë midis të anketuarave, me 8% dëshmitarë dhe 8% viktimat, gjë që vë në dukje se gratë e reja dhe vajzat tashmë ballafaqohen me forma të kontrollit financiar, varësisë ose kufizimit të mundësive.

Lidhur me ngacmimin seksual (7% viktimat, 7% dëshmitarë) dhe dhunën seksuale (1% viktimat, 2% dëshmitarë), të dhënat vënë në dukje raportimin relativisht të ulët. Megjithatë, këto shifra duhet të interpretohen me kujdes, pasi dhuna seksuale shpesh nuk raportohet për shkak të turpit, frikës dhe stigmës sociale.

Së fundi, vëzhgimi dhe ndjekja u raportua nga të anketuarat me 6% si viktimat dhe 8% si dëshmitarë, gjë që mund të lidhet me format në rritje të ndjekjes dhe kontrollit përmes rrjeteve sociale, formë kjo të cilën gratë e reja dhe vajzat shpesh e nënvlerësojnë.


Gjetjet e hulumtimit kualitativ vënë në dukje se problemi i dhunës thellohet në mënyrë plotësuese për shkak të mentalitetit konservator, barrierave kulturore dhe edukimit të pamjaftueshëm, të cilat kontribuojnë që dhuna të konsiderohet si turp dhe të pranohet si pjesë normale e jetës së përditshme. Prandaj, pjesëmarrësit/et pajtohen se format më të shpeshta dhe më shqetësuese të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit midis grave të reja dhe vajzave janë psikologjike dhe digjitale, sepse ato janë më të fshehurat, më të vështirat për t'u identifikuar dhe rrallë herë të sanksionuara.

Grafiku 14:

Prevalenca e dhunës

A keni qenë ndonjëherë (nga moshë 15 vjeç) viktimë e ndonjë lloji të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit në hapësirë publike (shkollë, fakultet, rrugë, punë, në institucione)?

Për secilën nga format e mëposhtme të dhunës, ju lutemi përgjigjuni me po, jo, ose nuk jam e sigurt



Në shumicën e formave të dhunës, vërehet një prevalencë më e lartë midis grave të reja dhe rome - 27% kanë përjetuar dhunë fizike, 40% dhunë psikologjike dhe 47% kanë përjetuar dhunë verbale. Ngacmimi seksual është mbi mesataren tek gratë e reja dhe vajzat nga mjediset rurale (10%) dhe tek të rejat shqiptare (10%).

Gjetjet e hulumtimit kuantitativ i konfirmojnë rezultatet se grupe të caktuara të grave të reja dhe vajzave janë më vulnerabile dhe të ekspozuara në rrezik më të lartë. Sipas mendimit të pjesëmarrësve/eve në diskutimet në grupe, më së shpeshti bëhet fjalë për vajza që vijnë nga familje jofunksionale, mjedise rurale dhe të mbyllura, bashkësia etnike rome, si dhe gra me lloje të ndryshme të aftësive të kufizuara. Për më tepër, varësia ekonomike, nivelet e ulëta të arsimit dhe mungesa e ndërgjegjësimit për atë që përbën dhunë, janë ndër faktorët më të theksuar që kontribuojnë që disa gra të reja dhe vajza të jenë më të ekspozuara ndaj dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit, nuk mund të plotësohet me këtë. Te këto grupe, dhuna shpesh normalizohet dhe pranohet nga shoqëria, ndërsa qasja në institucionet dhe shërbimet është e kufizuar. Mungesa e mbështetjes dhe mosbesimit ndaj sistemit kontribuojnë në raportimin e ulët të rasteve të dhunës. Veç tjerash, shumë gra të reja dhe vajza nuk e identifikojnë dhunën psikologjike, ekonomike ose digjitale, sepse mungon edukimi dhe udhëzime të qarta për kufijtë e sjelljes normale dhe të papranueshme. Kjo në mënyrë plotësuese e vështirëson raportimin dhe veprimin në kohë.

Format e dhunës

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se format e ndryshme të dhunës ndodhin në mjedise të ndryshme, me ç'rast më shpesh e pranishme është dhuna psikologjike, verbale dhe seksuale. Në banesë, më të përhapura janë sjellja kontrolluese dhe format ekonomike të dhunës (49% dhe 65%), gjë që tregon praninë e varësisë dhe kontrollit në marrëdhëniet intime. Banesa, megjithëse duhet të jetë një vend i sigurt, ajo na paraqitet si hapësirë me rrezik të lartë për gratë e reja dhe vajzat për sa i përket dhunës nga partneri intim.

Në hapësirën publike, veçanërisht në rrugë, ka incidencë më të lartë të ngacmimit seksual (64%) dhe vëzhgimit (68%), gjë që konfirmon se gratë shpesh janë të ekspozuara ndaj komenteve, ndjekjeve dhe ngacmimeve të padëshiruara gjatë lëvizjeve ditore. Transporti publik, parqet dhe kafenetë janë gjithashtu vende të rrezikshme për ngacmime seksuale, veçanërisht në mbrëmje.

Institucionet arsimore (shkollat dhe fakultetet) tregojnë një prevalencë të lartë të dhunës psikologjike dhe verbale (deri në 45%), gjë që vë në dukje praninë e keqtrajtimit të bashkëmoshatarëve dhe sjelljeve diskriminuese në mjedisin akademik. Vëzhgimi është i pranishëm edhe në shkolla (26%), i cili mund të ndërlidhet me ngacmimin digjital ose izolimin social. Dhuna psikologjike (14%) dhe ekonomike (15%) vërehen në mjedisin e punës, e cila më së shpeshti manifestohet si mobing, presion ose kufizim të mundësive profesionale. Në banesat e miqve dhe konviktet e studentëve, megjithëse përqindjet janë më të ulëta, ngacmimi seksual (43%) mbetet një rrezik i konsiderueshëm.

Këto të dhëna vënë në dukje se dhuna ndaj grave të reja dhe vajzave është e përhapur gjerë e gjatë dhe shfaqet në forma të ndryshme në varësi të kontekstit dhe hapësirës ku ndodh.

Tabela 1:**Vendet e dhunës**

Ju lutem më tregoni se ku e keni përjetuar dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin.


Ku e keni përjetuar dhunën	Dhuna fizike (N=72)	Dhuna psikologjike (N=96)	Dhuna verbale (N=141)	Ngacmimi seksual (N=39)	Dhuna seksuale (N=7)	Dhuna ekonomike (N=48)	Vëzhgimi/ndjekja (N=38)	Kontrolli nga partneri (N=39)
Në banesë	24%	24%	18%	15%	14%	65%	13%	49%
Në fqinjësi	14%	8%	14%	13%	43%	8%	11%	3%
Në shkollë	38%	45%	39%	13%		6%	26%	15%
Në fakultet	4%	5%	4%	5%	14%	4%	3%	
Në spital	7%	1%	3%	5%	14%	2%		5%
Në park	11%	7%	20%	26%	29%	8%	26%	15%
Në rrugë	21%	35%	53%	64%	29%	2%	68%	26%
Në kafeteri, restorant ose klub	10%	11%	21%	13%	29%		18%	31%
Në hapësirë parkimi	10%	5%	9%	15%	43%	2%	3%	3%
Në transportin publik	8%	9%	6%	13%		2%	3%	8%
Në stacionin e policisë	3%	1%	1%	3%	14%			
Në shtëpinë e mikut/es	8%	5%	4%	3%		4%	3%	23%
Në vendin e punës	4%	7%	11%	5%	29%	15%	5%	13%
Në internat/ konviktin e studentëve	6%	4%	2%	3%			8%	5%

Raportimi i dhunës

Një përqindje e lartë e reja dhe vajzave (89%) që kanë përjetuar (34% e të anketuarave) ose kanë qenë dëshmitare të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit (43%) nuk e kanë raportuar të njëjtën. Këto të dhëna janë alarmante dhe tregojnë se dhuna më së shpeshti mbetet e fshehur. Në kontekstin e të dhënave të mëparshme (që tregojnë një përhapje të lartë të ngacmimit psikologjik, verbal dhe seksual), kjo do të thotë që shumë gra vuajnë dhunë pa kërkuar ndihmë. Ky rezultat vë në dukje se viktimat shpesh lihen të vetëm në procesin e luftimit të dhunës.

Grafiku 15:
Raportimi i dhunës

A e keni raportuar incidentin?



Hulumtimi kualitativ e konfirmon nivelin e ulët të raportimit të dhunës. Organizatat mund të kontribuojnë ndjeshëm në rritjen e raportimit dhe besimit në institucione duke krijuar shembuj realë dhe të dukshëm të suksesit, mbështetjes afatgjatë dhe komunikimit të qartë me publikun. Pjesëmarrësit/et theksojnë se është e rëndësishme të promovohen histori pozitive - raste kur viktimat kanë marrë mbrojtje dhe drejtësia është arritur - sepse kjo ndërton besimin se sistemi mund të funksionojë. Njëherësh, nevojiten fushata mediatike serioze dhe të vazhdueshme, jo veprime afatshkurtra, me qëllim rritjen e ndërgjegjësimit dhe inkurajimin e reagimit të qytetarët.

Arsyet e mos-raportimit

Arsyeja më e shpeshta të mos raportimit të dhunës nga gratë e reja dhe vajzat që janë shfaqur si viktimë ose dëshmitare të një incidenti dhune me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi është frika (31%) - e cila mund të rezultojë nga hakmarrja e kryerësit, humbja e privatësisë, gjykimi i mjedisit ose nga mosbesimi ndaj rezultatit të procedurës. Kjo tregon se gratë nuk ndihen të mbrojtura as në kontekstin ligjor dhe as në atë shoqëror. Faktori i dytë më i shpeshtë është mosbesimi ndaj institucioneve (27%), që tregon një dobësi sistematike të institucioneve (policia, shërbimet sociale, gjykatat) dhe një perceptim se ato nuk do të ndërmarrin veprime ose do të jenë joefektive, ndërsa në mënyrë plotësuese 21% e grave të reja dhe vajzave e kanë theksuar turpin si arsye për mos raportimin e incidentit, gjë që tregon se normat shoqërore dhe stigma rreth viktimit të dhunës janë ende të pranishme fuqishëm. Gratë e reja dhe vajzat kanë frikë nga gjykimi, akuzat ose dëmtimi i reputacionit.

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarave nuk dinë se ku dhe si të raportojnë □ 16% e grave të reja dhe vajzave që nuk e kanë raportuar incidentin deklaruan se arsyeja për këtë është informimi i pamjaftueshëm ku ta raportojnë atë, gjë që vë në dukje mungesën e promovimit publik të shërbimeve dhe kanaleve të qasshme (linjat SOS, qendrat për mbështetje).


Pjesëmarrësit/et nga organizatat qytetare në diskutimet e fokus grupeve gjithashtu e theksuan këtë problem, përkatësisht u apostrofua se shumë gra të reja dhe vajza nuk janë të informuara sa duhet për atë që duhet të bëjnë, veçanërisht kur nuk i besojnë policisë, kështu që organizatat qytetare shpesh marrin këtë rol.

Presionin që e ndjejnë gratë e reja dhe vajzat për të mos e raportuar incidentin shfaqet në nivele të ndryshme dhe sipas deklaratave të të anketuarave vjen nga miqtë/shoqet (14%), mjedisi (11%) dhe familja (10%).

Grafiku 16:

Arsyet e mos-raportimit

Pse nuk e raportove dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin?



Gjetjet e hulumtimit kuantitativ u konfirmuan edhe në diskutimet në grupe. Sipas pjesëmarrësve/eve në hulumtimin kualitativ, arsyt kryesore pse gratë e reja dhe vajzat nuk e raportojnë dhunën me bazë gjinore janë frika, turpi dhe mosbesimi ndaj institucioneve. Frika nga hakmarrja, gjykimi nga mjedisi dhe mundësia që dhunuesi të zbulojë se viktima e ka raportuar e rrit pasigurinë dhe rrezikun. Turpi, faji dhe frika nga stigma publike i çojnë viktimat të heshtin. Mosbesimi ndaj institucioneve dhe bindja se raportimi nuk do të sjellë mbrojtje ose ndëshkim i dekurajon në mënyrë plotësuese. Varësia ekonomike është gjithashtu një faktor i rëndësishëm - shumë gra të reja dhe vajza nuk kanë ku të shkojnë ose nuk kanë mjete për t'u bërë të pavarura. E gjithë kjo krijon një rreth heshtjeje, i cili mund të thyhet vetëm nga besimi më i madh në sistem, mbrojtja efektive dhe ndryshimi i qëndrimeve shoqërore ndaj viktimave.

Mekanizmat e luftimit


Reagimi më i shpeshtë pas incidentit të përjetuar (si viktimë ose dëshmitare) midis grave të reja dhe vajzave është kërkesa e mbështetjes emocionale në rrjetet joformale - 34% e të anketuarave që kanë përjetuar incident dhune me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi deklaruan se kanë biseduar me ndonjë person të afërt (mik/eshë, familjar, mësimdhënës/e).

Hapi i dytë më i zakonshëm që ata e kanë ndërmarrë është largimi nga mjedisi i dhunshëm (puna, lidhja, banesa, etj.) - 31% e viktimave dhe dëshmitareve të dhunës e kanë ndërmarrë këtë hap, gjë që vë në dukje se një përqindje e konsiderueshme e grave të reja dhe vajzave vendosin të mbrojnë veten në mënyrë të pavarur. Kërkimi i mbështetjes psikologjike ose këshillimit është një hap pozitiv, por një përqindje e ulët e viktimave dhe dëshmitareve të dhunës me bazë gjinore (7%) e kanë bërë këtë.

Grafiku 17:

Hapat e ndërmarra

Çfarë ndërmorët pas përjetimit të incidentit?



Boshllëqe në mbrojtjen institucionale dhe ligjore

Përgjigjet e të anketuarave që ishin viktimat ose dëshmitarë të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit tregojnë se ajo që mungon më së shumti në veprimet e institucioneve në rastet e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit është ndëshkimi i duhur, mbrojtja e viktimave dhe reagimi i shpejtë, gjë që e vë në dukje joefikasitetin sistematik dhe mosbesimin ndaj institucioneve.

Vërejtja më e shpeshtë është se dhunuesit nuk ndëshkohen mjaftueshëm rëndë ose në kohën e duhur - kjo theksohet nga 65% e të anketuarave që kanë qenë viktimat ose dëshmitarë të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit. Kjo krijon ndjenjë mosndëshkimi dhe zvogëlon besimin në sistemin e drejtësisë dhe i dekurajon viktimat të raportojnë.

Për më tepër, 56% e të anketuarave që kanë qenë viktimat ose dëshmitarë konsiderojnë se viktimës i mungon mbrojtja dhe mbështetja. Kjo tregon se institucionet nuk ofrojnë mbrojtje të mjaftueshme psikologjike, ligjore dhe fizike për viktimat.

Të anketuarat janë të mendimit se institucionet reagojnë ngadalë ose në mënyrë joefikase - mangësi që e kanë theksuar 55% e të anketuarave që kanë qenë viktimat ose dëshmitarë të dhunës me bazë gjinore. Sipas mendimit të grave të reja dhe vajzave që janë viktimat ose dëshmitarë të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit, shpesh ndodh prolongimi i procedurave, jo efikasitet dhe mungesë koordinimi midis shërbimeve. Reagimi i shpejtë është thelbësor për parandalimin e dëmit të mëtejshëm, por në praktikë shpesh mungon.


Gjetjet e hulumtimit kualitativ e potencojnë problemin me reagimin e shpejtë. Sipas mendimit të pjesëmarrësve/eve në diskutimet në grupe, ajo që mungon më shumë në veprimet e institucioneve është reagimi i shpejtë dhe në kohë, si dhe një qasje serioze dhe të ndjeshme ndaj viktimave. U theksua se shumë gra të reja dhe vajza mendojnë se institucionet nuk e kuptojnë situatën e dhunshme si një problem serioz, gjë që e rrënon besimin e tyre dhe i inkurajon ta fshehin dhunën ose të mos e raportojnë.

Informimi dhe parandalimi (35%), bashkëpunimi ndërinstitutional (31%) dhe personat e informuar dhe të trajnuar (29%) janë aspektet e tjera të detektuara si mangësi në veprimin e institucioneve në rastet e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit.

Grafiku 18:

Boshllëqe në mbrojtjen institucionale dhe ligjore

Sipas mendimit tuaj, çfarë mungon më shumë në veprimet e institucioneve në rastet e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit?



Faktorët e sigurisë më të madhe

Lidhur me pyetjen se cilët faktorë do të kontribuonin për një siguri më të madhe për gratë e reja dhe vajzat në hapësirat publike, rezultatet tregojnë se të anketuarat më shpesh e theksojnë nevojën për institucione më aktive, reagime më të shpejta dhe prani të shtuar të policisë, por njëherësh edhe për aktivitete edukative dhe informative që do ta ndryshojnë qëndrimin shoqëror ndaj dhunës.

Masa e theksuar më shpesh është reagimi më i shpejtë nga institucionet kompetente (48%). Kjo e konfirmon përshtypjen se institucionet ekzistuese reagojnë ngadalë, gjë që e rit ndjenjën e pasigurisë.


Mbështetja nga institucionet (shërbimet sociale, policia, gjyqësori) është masa e dytë më shpesh e theksuar (46%), që e vë në dukje se gratë e reja presin mbështetje të vazhdueshme institucionale, jo vetëm në kohën e raportimit, por edhe më tej – psikologjike, ligjore dhe sociale.

Prania më e madhe e policisë dhe infrastruktura më e mirë e ndriçimit dhe sigurisë (video mbikëqyrja) theksohen si masa nga 34% përkatësisht 33% të grave të reja dhe vajzave.

Grafiku 19:

Faktorët e sigurisë më të madhe

Çfarë do të ndihmonte për sigurinë më të madhe të grave të reja dhe vajzave në hapësirën publike?



Qasshmëria e institucioneve

Si institucionet mund të bëhen më të qasshme dhe më të besueshme për gratë e reja dhe vajzat, e cila është një çështje kryesore në përmirësimin e përgjigjes institucionale ndaj dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit, ishte një pyetje që iu parashtrua grave të reja dhe vajzave.

Rezultatet e pasqyrojnë perceptimin e grave të reja dhe vajzave për atë që mungon në qasshmërinë institucionale ndaj nevojave të tyre. Kërkesat e ranguara më lartë janë kërkesat e besueshmërisë, qasjes së lehtë dhe komunikimit të hapur, gjë që vë në dukje mungesën e transparencës dhe bashkëpunimit midis institucioneve dhe grave të reja dhe vajzave.


Përgjigja më e shpeshtë e institucioneve ta garantojnë besueshmërinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, gjë që tregon se gratë e reja dhe vajzat nuk ndihen të sigurt për të shkëmbyer informacione personale kur raportojnë dhunë ose kërkojnë ndihmë. Mosbesimi në sistemin e mbrojtjes së të dhënave e minon gatishmërinë të kërkohej mbështetje institucionale.

Më shumë se gjysma (52%) e grave të reja dhe vajzave presin nga institucionet të kenë një qasje të personalizuar dhe senzitive dhe 45% gjithashtu presin që institucionet të zhvillojnë fushata për rritjen e ndërgjegjësimit dhe besimit te të rinjtë. Çdo e katërta nga dhjetë gra të reja dhe vajza (41%) gjithashtu presin që institucionet të kenë qasje të lehtë fizik dhe online në shërbime pa procedura komplekse.

Grafiku 20:

Mënyrat për institucione më të qasshme

Si mund të bëhen institucionet më të qasshme dhe më të besueshme për gratë e reja dhe vajzat ?



Mjedisi online dhe dhuna digjitale

Prevalenca e dhunës në hapësirën digjitale


Rezultatet vënë në dukje se një numër i konsiderueshëm i grave të reja dhe vajzave në Maqedoninë e Veriut kanë përvojë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me dhunën në hapësirën digjitale (siç janë rrjetet sociale, mesazhet sms, e-posta, forumet, thirrjet telefonike, lokalizuesit GPS, etj.) që nga adoleshenca e tyre. Megjithëse shumica deklaruan se nuk kanë qenë viktimë, ekziston një probabilitet i madh i shfaqjes së nënvlerësuar të dhunës, veçanërisht në rastet e keqtrajtimit onlajn psikologjik, verbal dhe ekonomik.

Rreth një në dhjetë të anketuara kanë përjetuar personalisht ndonjë formë të dhunës pas moshës 15 vjeç, ndërsa 15% kanë qenë dëshmitare të dhunës ndaj një personi tjetër në hapësirën digjitale. Këto përqindje tregojnë se dhuna është reale dhe e pranishme në hapësirën digjitale, madje edhe kur nuk i drejtohet drejtpërdrejt atyre.

Grafiku 21:

Përvoja me dhunën në hapësirën digjitale

A keni qenë ndonjëherë (nga mosha 15 vjeç) viktimë e ndonjë forme të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit në hapësirën digjitale (në rrjetet sociale, mesazhet sms, e-postën, forumet, thirrjet telefonike, lokalizuesit GPS, etj.)?



Sipas gjetjeve të hulumtimit cilësor, dhuna digjitale është një fenomen gjithnjë e më i zakonshëm dhe serioz, veçanërisht në mesin e grave dhe vajzave të reja. Të gjithë pjesëmarrësit/et deklarojnë se, në një masë më të vogël ose më të madhe, kanë qenë dëshmitare të një forme të dhunës digjitale, siç janë komentet ofenduese, kërcënimet, profilet e rreme, shpërndarja dhe editimi i fotografive pa leje. Nga ana tjetër, organizatat qytetare dëshmojnë se rastet e tilla i prekin më shpesh të miturat, të cilat nuk e kuptojnë seriozitetin e situatës dhe nuk janë të vetëdijshme për pasojat.

Format e dhunës në hapësirën digjitale

Sa i përket formave online të dhunës me bazë gjinore dhe ngacmimit, të cilat ndodhin gjithnjë e më shpesh te gratë e reja dhe vajzat, rezultatet tregojnë se format më të zakonshme janë profilet e rreme, komentet ofenduese dhe mesazhet e padëshiruara, gjë që vë në dukje një problem serioz me sigurinë e grave të reja dhe vajzave në hapësirën digjitale.

Forma më e shpeshtë e ngacmimit digjital është krijimi i një profili të rremë - gjysma e grave të reja dhe vajzave që kanë përjetuar (55%) ose kanë qenë dëshmitare (54%) të dhunës me bazë gjinore kanë deklaruar se dikush ka krijuar një profil të rremë me imazhin ose identitetin e tyre. Kjo e kërcënon privatësinë dhe sigurinë, dhe shpesh përbën një formë të dhunës psikologjike dhe manipulimit.


Komentet fyese ose nënçmuese janë gjithashtu një dukuri shumë e shpeshtë e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit të përjetuar nga 45% e viktimave dhe 50% e dëshmitareve të këtij lloji të dhunës dhe/ose ngacmimit në hapësirën digjitale.

Format e dhunës dhe/ose ngacmimit në hapësirën digjitale përhapen edhe përtej rrjeteve sociale tregon se një e treta (33%) e grave të reja dhe vajzave që kanë qenë viktima dhe një e katërta (25%) e atyre që ishin dëshmitare të dhunës në hapësirën digjitale theksuan se kjo ka ndodhur përmes thirrjeve telefonike ose mesazheve SMS.

Grafiku 22:

Format e DHBGJ në hapësirën digjitale

Cila nga format e mëposhtme të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit i keni përjetuar ose keni qenë dëshmitare në hapësirën digjitale?



Në përgjithësi, të gjithë pjesëmarrësit/et në grupet fokus theksojnë se dhuna digjitale është një dukuri gjithnjë e më e shpeshtë dhe serioze, veçanërisht në mesin e të rinjve dhe grave. Të gjithë pjesëmarrësit/et deklarojnë se, në një masë më të vogël ose më të madhe, kanë qenë dëshmitare të ndonjë forme të dhunës digjitale, siç janë komentet ofenduese, kërcënimet, profilet e rreme, ndarja dhe editimi i fotografive pa leje.

Platforma

Facebook mbetet vendi më i zakonshëm i ngacmimeve në internet - 74% e grave të reja dhe vajzave të anketuara që kanë përjetuar ose kanë qenë dëshmitare të dhunës me bazë gjinore në hapësirën digjitale e kanë theksuar këtë rrjet social si platformën ku ka ndodhur ajo. Platforma është e popullarizuar në mesin e grup moshave të ndryshme, duke e bërë atë të ndjeshme ndaj abuzimeve dhe gjuhës së urrejtjes, veçanërisht për shkak të komenteve publike, grupeve dhe mundësisë për të krijuar profile të rreme.


Platforma e dytë më e përmendur është Instagrami - 41% e kanë theksuar këtë rrjet social ku ka ndodhur dhuna dhe/ose ngacmimi. Ngacmimi në Instagram ndodh më shpesh përmes mesazheve të drejtpërdrejta, komenteve dhe ndarjes së paautorizuar të fotografive. Kjo e konfirmon lidhjen midis natyrës vizuale të platformës dhe formave të ndryshme të dhunës.

Megjithëse përqindja është më e ulët (18%), TikTok përfaqëson një zonë në rritje të ngacmimeve, veçanërisht përmes komenteve negative dhe videove përbuzëse.

Grafiku 23:

Platforma ku u përjetua/dëshmuar dhuna

Në cilat platforma keni përjetuar ose keni qenë dëshmitare e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit?



Sipas njohurive të pjesëmarrësve/eve në diskutimet në grupe, dhuna digjitale është e pranishme në të gjitha platformat online, veçanërisht në ato që përdoren më shpesh nga të rinjtë, si TikTok, Instagram, Snapchat, Facebook dhe Telegram, përkatësisht në platformat përmes të cilave ndahen përmbajtje të ndryshme - foto, video dhe materiale të tjera.

Raportimi i dhunës


Ngjashëm me rastet e dhunës në hapësirën publike, një përqindje e lartë e grave të reja dhe vajzave (86%) që kanë përjetuar ose ishin dëshmitare të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit në hapësirën digjitale nuk e kanë raportuar incidentin. Vetëm një prej dhjetë e ka raportuar incidentin dhe këtë e ka bërë kryesisht në polici ose në vetë rrjetin social ku ndodhi dhuna dhe/ose ngacmimi.

Grafiku 24:

Raportimi i dhunës në hapësirën digjitale

A e keni raportuar incidentin e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit që e keni përjetuar ose dëshmuar?

■ Po ■ Jo ■ Nuk e di /Refuzon të përgjigjet



Rezultatet tregojnë se shumica e grave të reja dhe vajzave nuk e raportojnë dhunën që e kanë përjetuar, kryesisht për shkak të barrierave emocionale, mosbesimit në institucionet dhe informimit të pamjaftueshëm. Këto gjetje e konfirmojnë dukurinë permanente të kulturës së heshtjes dhe stigmatizimit rreth dhunës me bazë gjinore në shoqërinë maqedonase.


Arsyeja më e shpeshtë pse nuk raportohet dhuna është informimi i pamjaftueshëm se ku të raportohet (31%), gjë që e vë dukje mungesën serioze të ndërgjegjësimit të publikut për mekanizmat dhe institucionet ekzistuese ku mund të raportohet dhuna.

Pothuajse një e treta e të anketuarave (28%) deklaruan se nuk e kanë raportuar incidentin sepse nuk kanë besim tek institucionet, gjë që e vë në dukje perceptimin se sistemi është joefikas, i avashtë ose nuk ofron mbrojtje reale.

Grafiku 25:

Arsyet e mos-raportimit

Për cilat arsye nuk e raportuat dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin në hapësirën digjitale?



Rezultatet e kësaj pyetjeje tregojnë qartë se frika, turpi dhe mosbesimi në institucionet janë tre faktorët më të rëndësishëm që i pengojnë gratë e reja ta raportojnë dhunën me bazë gjinore. Informimi i pamjaftueshëm për procedurat dhe shërbimet e qasshme e thellojnë heshtjen rreth rasteve të tilla. Prandaj, është e nevojshme që institucionet të ndërmarrin veprime të koordinuara për dukshmëri, transparencë dhe mbështetje më të mirë të viktimave, si dhe të organizohen fushata që do të nxisin besimin dhe guximin për të raportuar.

Edhe gjetjet e hulumtimit kualitativ lidhur me atë nëse gratë e reja dhe vajzat kanë besim ta raportojnë dhunën digjitale tek institucionet vënë në dukje se besimi është shumë i ulët ndërsa raportimi i rasteve të tilla është i rrallë. Shumica e pjesëmarrësve/eve pajtohen se arsyeja më e shpeshtë për këtë është informimi i pamjaftueshëm dhe edukimi i të rinjve për atë që përbën dhuna digjitale dhe ku ta raportojnë atë. Veç tjerash, pjesëmarrësit/et theksuan se madje edhe kur raportohet dhuna digjitale, rrallë ndërmerren masa konkrete kurse viktimat këshillohen më shpesh që thjesht t'i injorojnë fyerjet. Mungesa e mekanizmave të qartë të raportimit, së bashku me reagimet e avashta të policisë dhe procedurat e gjata gjyqësore, krijon një ndjenjë pafuqie dhe dekurajimi midis grave të reja dhe vajzave. Vështirësia në sigurimin e provave është gjithashtu një problem, pasi disa rrjete sociale nuk bashkëpunojnë me institucionet maqedonase, gjë që e komplikon në mënyrë plotësuese procesin e sanksionimit të kryerësve.

Mekanizmat e luftimit

Kur u pyetën se çfarë ndërmorën pasi përjetuan incidentin e dhunës dhe/ose ngacmimit, më shumë se gjysma e të anketuarave (56%) deklaruan se u përpoqën ta shmangin vetë burimin e ngacmimit. Kjo e konfirmon mosbesimin në mekanizmat institucionale dhe e potencon nevojën për instrumente të qasshme digjitale për raportim.

Pothuajse çdo e treta e anketuar (30%) deklaroi se ka kërkuar ndihmë nga një mik/eshë ose nga familja, përgjigje që e konfirmon se viktimat më së shpeshti mbështeten në ndihmën joformale se sa në atë institucionale.


Një e katërta e të anketuarave (26%) kanë përdorë instrumente në vetë platformat (raportimi i përmbajtjes ose profilit).

Një numër i konsiderueshëm i grave të reja dhe vajzave (18%) u tërhoqën nga aktiviteti online pas incidentit të përjetuar përkatësisht reagues me vetëpërmbajtje, gjë që tregon ndikimin psikologjik të dhunës dhe ndjenjën e pafuqisë.

Grafiku 26:

Veprimet e ndërmarra

Çfarë keni ndërmarrë mbas përjetimit të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit në hapësirën digjitale?



Faktorët e DHBGJ në hapësirën digjitale

Rezultatet tregojnë se dhuna onlajn nuk është e rastësishme, por një problem sistemik, i nxitur nga mungesa e sanksioneve, rregullimi i dobët dhe toleranca kulturore ndaj dhunës. Kombinimi i anonimitetit, përhapjes së shpejtë dhe mosinformimit krijon një mjedis në të cilin dhuna riprodhohet lehtësisht. Kontribuuesit më të mëdhenj në dhunën me bazë gjinore në hapësirën digjitale janë mungesa e sanksioneve, anonimiteti i sulmuesve dhe përhapja e lehtë e përmbajtjeve ofenduese. Njëkohësisht, të rinjtë i identifikojnë edhe faktorët shoqërorë - siç është presioni grupor dhe normalizimi i vokabularit të dhunshëm.

Kur u pyetën se cilët faktorë kontribuojnë në dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin në hapësirën digjitale, gjysma e të anketuarave (50%) mendojnë se ndëshkimi i pamjaftueshëm dhe mosndëshkimi i kryerësve e krijon ndjenjën e mosndëshkimit. Pa pasoja reale, dhunuesit vazhdojnë me sjelljen e tyre.

Faktori i dytë më i zakonshëm është anonimiteti i internetit (41%), i cili u mundëson kryerësve të veprojnë pa frikë nga zbulimi, gjë që e inkurajon sjelljen agresive dhe ofenduese.


Më shumë se një e treta e të anketuarave (39%) janë të mendimit se përhapja e shpejtë e përmbajtjeve fyese është një faktor që kontribuon në dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin në hapësirën digjitale, veçanërisht e mundësuar përmes përhapjes së imazheve, komenteve dhe videove në rrjetet sociale, me pasoja për viktimën që janë të shpejta dhe shpesh të parikuperueshme, pasi përmbajtja shpërndalet brenda disa minutash.

Një pjesë e konsiderueshme e të anketuarave, gjithashtu, i theksuan platformat e nën-rregulluara (29%), edukimin e pamjaftueshëm për të drejtat digjitale (27%) dhe normalizimin e vokabularit agresiv dhe sjelljes së dhunshme (27%) si faktorë kontribuues në dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin në hapësirën digjitale.

Grafiku 27:

Faktorët e DHBGJ në hapësirën digjitale

Cilët faktorë kontribuojnë në dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin në hapësirën digjitale?



Faktorët e sigurisë më të madhe

Rezultatet tregojnë qartë se gratë reja dhe vajzat duan një sistem të integruar të parandalimit dhe mbështetjes, i cili përfshin reagimin institucional, rregulla të qarta të platformave, instrumente teknologjike për mbrojtje dhe edukim të vazhdueshëm.

Gratë e reja dhe vajzat e identifikojnë rolin e institucioneve - 51% e të anketuarave deklaruan se mbështetja nga institucionet (institucionet arsimore, shërbimet sociale, policia, gjyqësori) është diçka që do të ndihmonte për një siguri më të madhe në hapësirën digjitale.


Gratë e reja dhe vajzat kërkojnë moderim më të rreptë dhe politika të rrjeteve sociale që do të parandalojnë përhapjen e përmbajtjeve fyese dhe do ta sanksionojnë sjelljen e dhunshme - 45% e të anketuarave deklaruan se janë të nevojshme rregulla të qarta dhe të rrepta të sjelljes në platformat online.

Gratë e reja dhe vajzat janë të mendimit se mekanizmat praktikë dhe të qasshëm të reagimit të shpejtë do të ndihmonin në rritjen e sigurisë në hapësirën digjitale - 43% deklaruan se ekzistimi i instrumenteve digjitale për raportimin dhe bllokimin e dhunuesve është zgjidhje e mirë në luftën kundër dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit në hapësirën digjitale.

Grafiku 28:

Faktorët për siguri më të madhe

Çfarë do të ndihmonte për sigurinë më të madhe të grave të reja dhe vajzave në hapësirën digjitale?



KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME



Konkluzione

1. Hulumtimi vë në dukje se dhuna me bazë gjinore është një fenomen i rrënjosur thellë dhe shpesh i panjohur, i cili vazhdon për shkak të mungesës së sanksioneve, joefikasitetit institucional dhe normalizimit të sjelljes së dhunshme. Dhuna me bazë gjinore dhe dhuna digjitale ndaj grave të reja dhe vajzave është një problem serioz dhe në rritje që kërkon një qasje sistemike dhe të koordinuar. Siguria e grave të reja dhe vajzave është një problem shumëdimensional që kërkon qasje institucionale, infrastrukturore dhe arsimore.
2. Të dhënat konfirmojnë se besimi institucional midis grave të reja është i pjesshëm. Megjithëse ndërgjegjësimi midis të rinjve është rritur ndërsa tema gjithnjë e më shpesh hapet para publikut, mosbesimi institucional dhe reagimi i ngadaltë mbeten pengesa kryesore për luftimin efektiv të dhunës. Ata priren të besojnë në institucionet me të cilat kanë kontakte të drejtpërdrejta dhe të përditshme (arsimore dhe shëndetësore), si dhe në polici dhe qendrat për punë sociale, ndërsa gjyqësori dhe prokuroria perceptohen si joefikase, të paqasshme dhe joempatike.
3. Institucionet në të cilat gratë dhe vajzat e reja kanë besim më të ulët janë identifikuar si ato me gabime më të mëdha në sanksionimin dhe ndëshkimin e duhur të dhunuesve. Dobësia sistemike, ngathtësia dhe ndjeshmëria e pamjaftueshme e personave zyrtarë e zvogëlojnë vullnetin e viktimave ta raportojnë dhunën, me ç'rast mangësitë më të mëdha vërehen në ndëshkimin e kryerësve, mbështetjen e viktimave dhe shpejtësinë e reagimit. Mungesa e stafit të sensibilizuar, mosharmonizimi midis institucioneve dhe kuadri i kufizuar ligjor në mënyrë plotësuese e komplikojnë problemin.
4. Gratë e reja dhe vajzat presin që institucionet të jenë më të qasshme, transparente dhe më të ndjeshme ndaj nevojave të tyre, duke i marrë parasysh prioritetet kryesore siç janë garancia e besueshmërisë, qasja e thjeshtë në shërbimet, mbështetja e specializuar dhe komunikimi i qartë dhe i drejtpërdrejtë sipas qasjes së bazuar në viktimën.

5. Organizatat qytetare gëzojnë besim më të madh dhe ofrojnë mbështetje psikologjike, ligjore dhe materiale (si strehimi dhe akomodimi i viktimave), megjithatë kapaciteti i tyre është i kufizuar, veçanërisht në mjediset rurale. Megjithatë, angazhimi i shtuar i organizatave qytetare, shembujt pozitivë nga shkollat dhe iniciativat për edukim dhe mbështetje përbëjnë bazë të rëndësishme për përmirësim.
6. Një numër i konsiderueshëm i grave të reja dhe vajzave kanë përvojë direkte ose indirekte të dhunës që nga adoleshenca e tyre. Megjithëse shumica deklaruan se nuk kanë qenë viktimë, ekziston një probabilitet i madh i shfaqjes së nënvlerësuar të dhunës, veçanërisht në rastet e ngacmimit dhe abuzimit psikologjik, verbal dhe ekonomik. Gratë e reja dhe vajzat janë gjithnjë e më të ekspozuara ndaj formave të ndryshme të dhunës me bazë gjinore dhe / ose ngacmimit - veçanërisht dhuna psikologjike, verbale, ekonomike dhe digjitale, të cilat, edhe pse më të përhapura, mbeten më pak të identifikuar dhe të sanksionuara.
7. Pikëpamjet dhe normat patriarkale, niveli i ulët i informimit (njohurive) kontribuojnë në normalizimin dhe shpesh minimizimin e dhunës, veçanërisht brenda familjes dhe në marrëdhëniet e partnerëve.
8. Dhuna ndodh kudo, por shtëpia, rruga dhe hapësirat publike janë vendet më të rrezikshme ku gratë e reja përballen me forma të ndryshme të dhunës. Format e kontrollit ekonomik të dhunës janë më të përhapura në banesë. Në rrugë dukuri më të përhapura janë ngacmimi seksual dhe vëzhgimi, gjë që e konfirmon pasigurinë e grave në hapësirat publike. Shkollat dhe fakultetet janë vatra të dhunës psikologjike dhe verbale.
9. Frika, turpi dhe mosbesimi në institucione janë tre faktorët më të rëndësishëm që i pengojnë gratë e reja dhe vajzat të raportojnë dhunën me bazë gjinore. Informimi i pamjaftueshëm i procedurave dhe shërbimeve të qasshme janë faktorë shtesë që kontribuojnë në probabilitetin e ulët të raportimit të rasteve. Frika nga gjykimi, hakmarrja dhe stigma, së bashku me varësinë ekonomike dhe mungesën e mekanizmave të sigurt për raportimin anonim, i dekurajojnë viktimat të kërkojnë ndihmë.
10. Gratë e reja dhe vajzat kryesisht reagojnë përmes strategjive të shmangies dhe vetëmbrojtjes dhe jo përmes kanaleve institucionale. Gratë e reja dhe vajzat më së shumti reagojnë brenda rrjetit personal ose joformal të mbështetjes, ndërsa raportimi institucional dhe kërkesa e ndihmës janë të rralla.
11. Dhuna digjitale po bëhet një formë gjithnjë e më e shpeshtë dhe serioze e dhunës, e cila më së shumti i godet gratë e reja dhe vajzat. Format më të shpeshta të dhunës në hapësirën digjitale janë krijimi i profileve të rreme, komentet ofenduese dhe mesazhet e padëshiruara, ndërsa rrjetet sociale janë hapësira kryesore ku gratë e reja dhe vajzat përjetojnë ose dëshmojnë dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin.

12. Kombinimi i anonimitetit, përhapjes së shpejtë dhe mosinformimit krijon një mjedis në të cilin dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi në hapësirën digjitale riprodhohet lehtësisht.
13. Raportimi i dhunës onlajn është shumë i rrallë për shkak të mosbesimit në institucionet, informimit të pamjaftueshëm dhe identifikimit të dhunës, si dhe mekanizmave joefektivë të mbrojtjes.
14. Gratë e reja dhe vajzat presin një sistem të integruar të parandalimit dhe mbështetjes në rastet e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit në hapësirën digjitale, i cili përfshin reagimin institucional, rregulla të qarta për përdorimin e platformave, instrumente teknologjike për mbrojtje dhe edukim të vazhdueshëm.

Rekomandime

Lidhur me konkluzionin 3, 4, 5 dhe 6: Forcimi i efikasitetit institucional dhe mbështetjes jashtë institucionale

1. Krijimi i protokolleve të qarta për veprim, trajnim të personave zyrtarë dhe reagimi i shpejtë. Rritja e sigurisë kërkon reagim të shpejtë dhe efikas institucional pas raportimit, mbështetje të vazhdueshme dhe forcimin e sistemeve të mbrojtjes dhe praninë e policisë në hapësirën publike.
2. Efikasitet dhe bashkëpunim multi sektorial i institucioneve që do të sigurojë përgjigje më të shpejtë dhe më të koordinuar duke siguruar personel të trajnuar në çdo stacion policie, prokurori dhe qendrat për punë sociale për trajtimin senzitiv dhe profesional të rasteve të dhunës, si dhe burime të mjaftueshme njerëzore dhe financiare për shërbime funksionale siç janë strehimet dhe ndihma dhe mbështetja psikologjike falas.
3. Mbështetje jashtë institucionale për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit duke mbështetur organizatat qytetare dhe qendrat rinore që punojnë me viktimat e dhunës.
4. Përfshirja e programeve për të punuar me kryerësit, të cilat do të mundësojnë risocializimin dhe reduktimin e rrezikut nga përsëritja e dhunës.

Lidhur me konkluzionin 7 dhe 8: Përfshirja e programeve gjithëpërfshirëse edukative

5. Programe arsimore të detyrueshme në shkolla: Përfshirja e edukimit për rolet gjinore, parandalimi i dhunës dhe edukimi seksual nga moshat e reja, duke përfshirë në mënyrë aktive prindërit për mbështetjen emocionale dhe praktike të fëmijëve dhe përmes integritetit të qasjeve që i përfshijnë në mënyrë aktive burrat dhe djemtë duke promovuar mashkulloritetin pozitiv, empatinë dhe respektin për barazinë gjinore.
6. Zhvillimi i programeve dhe aktiviteteve specifike për të rinjtë, të cilat do t' i udhëzojnë ata drejt angazhimit pozitiv dhe edukativ.
7. Programet edukative për identifikimin, parandalimin dhe raportimin e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit, edukimin seksual, me përfshirjen aktive të prindërve.
8. Forcimi i ndërgjegjësimit publik përmes fushatave dhe shembujve pozitivë, me qëllim nxitjen e besimit midis viktimave dhe promovimin e kulturës së përgjegjësisë dhe tolerancës zero ndaj dhunës.

Lidhur me konkluzionin 12,13,14 dhe 15: Parandalimi dhe mbrojtja nga dhuna me bazë gjinore në hapësirën digjitale

9. Gratë e reja dhe vajzat në mënyrë të vazhdueshme duhet të marrin edukim digjital. Përveç kësaj, të rinjtë duhet të marrin edukim të vazhdueshëm për raportimin e dhunës me bazë gjinore dhe keqpërdorimin e të dhënave personale. Ata duhet të njihen me rolin e institucioneve përgjegjëse si shkollat, policia dhe avokati i popullit si dhe me procedurën e raportimit të dhunës me bazë gjinore.
10. Platforma digjitale për mbështetje: Bashkimi i viktimave, profesionistëve dhe institucioneve në një vend, me mundësinë për të shkëmbyer përvoja, informacione për burimet dhe këshilla praktike, duke përfshirë edhe opsione anonime për mbrojtjen dhe motivimin e viktimave. Zgjerimi i përpjekjeve për informim dhe edukim përmes kanaleve të përshtatura për të rinjtë, duke përfshirë aplikacione mobile dhe platforma të mediave sociale, për përfshirjen në mënyrë efektive të të rinjve në parandalimin e dhunës me bazë gjinore.

ANEKSE

Aneksi 1 - Pyetësi

Pyetësi

Kohëzgjatja e intervistës:

Fillimi i punës në terren:

Fundi i punës në terren:

I. HYRJE

Mirëmëngjesi /Mirëdita/Mirëmbrema. Emri im është ... dhe punoj për Indago nga Shkupi, një agjenci e pavarur për hulumtimin e tregut dhe opinionit publik. Aktualisht e zbatojmë hulumtimin sa i përket përvojave, perceptimeve dhe sfidave me të cilat ballafaqohen gratë e reja dhe vajzat të moshës prej 18 deri në 29 vjeç në lidhje me dhunën me bazë gjinore, si në hapësirën publike ashtu edhe në atë digjitale.

Qëllimi i hulumtimit është të sigurojë të kuptuarit më të thellë të formave të ndryshme të dhunës, si dhe të pengesave gjatë qasjes në mbrojtje, mbështetje dhe drejtësi.

Pjesëmarrja juaj është plotësisht anonime dhe vullnetare dhe të gjitha të dhënat e grumbulluara do të përdoren ekskluzivisht për qëllime hulumtuese. Anketa zgjat rreth 30 minuta.

A dëshironi të merrni pjesë?

Para se të fillojmë, do t'ju lexoj një përkufizim për dhunën me bazë gjinore: "Dhuna me bazë gjinore ndaj grave" - është dhuna e drejtuar kundër gruas sepse ajo është grua ose që e prek atë në mënyrë disproporcionale. Dhuna me bazë gjinore ndaj grave i përfshin shkaqet dhe rezultatit e marrëdhënies së pabarabartë të pushtetit midis grave dhe burrave që rezulton nga një problem shoqëror dhe jo individual.

II. MODELI

Mosha

III. KUOTAT

Totali net: n=600 intervista

IV. PYETËSORI

S01 [S] Rajoni statistikor

INT: ZGJIDHNI RAJONIN NË TË CILIN ZHVILLOHET INTERVISTA

1. Rajoni i Vardarit,
2. Rajoni Lindor
3. Rajoni Jugperëndimor
4. Rajoni Juglindor
5. Rajoni i Pellagonisë
6. Rajoni i Pollogut
7. Rajoni Verilindor
8. Rajoni i Shkupit

Baza: të gjithë të anketuarit

S02 [S] Ku jetoni?

1. Mjedis urban (qyteti)
2. Mjedis rural (fshati/në fshat)

S03. [S] Sa vjeç jeni?

1. _____ vjet
2. Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

S03a. [S] Kategoritë e moshës madhore:

1. 18–21
2. 22–25
3. 26–29

IV. PYETËSORI

PRANIA E DHUNËS NË KONTEKSTE TË NDRYSHME SHOQËRORE

A01. Sa shpesh jeni ndjerë të pasigurt në një hapësirë publike për shkak të të qenit grua ose vajzë?

1. Shumë shpesh
2. Ndonjëherë
3. Rrallëherë
4. Asnjëherë
5. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

A02. A keni ikur ndonjëherë (nga mosha 15 vjeç) nga ndonjë aktivitet ose vend për shkak të frikës nga dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit ?

1. Po
2. Jo
3. Nuk më kujtohet
4. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

A03. Deri në cilën shkallë keni besim në institucionet dhe organizatat e mëposhtme (, , ,) kur bëhet fjalë për mbrojtjen nga dhuna me bazë gjinore ose ngacmimi?

	Kam besim të plotë (1)	Kam besim të pjesshëm (2)	As kam dhe as nuk kam besim (3)	Nuk kam aspak besim (4)	Refuzon të përgjigjet [NUK LEXOHEJ] (5)
Institucionet arsimore	1	2	3	4	5
Institucionet shëndetësore	1	2	3	4	5
Policia	1	2	3	4	5
Qendrat për punë sociale	1	2	3	4	5
Organizatat qytetare	1	2	3	4	5
Prokuroria Publike	1	2	3	4	5
Gjykatat	1	2	3	4	5

A04. [M-deri në 3 përgjigje, rotacioni i përgjigjeve] Cilat institucione dhe/ose organizata mendoni se duhet të kenë një rol kryesor në luftimin e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit? Zgjidh deri në 3 përgjigje

1. Policia
2. Gjykatat
3. Shërbimet sociale/Qendra për Punë Sociale
4. Vetëqeverisja lokale/komuna
5. Prokuroria Publike
6. Institucionet arsimore
7. Institucionet shëndetësore
8. Organizatat qytetare
9. Media
10. Tjetër:
11. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme deri në 3 përgjigje

A05. [S] A mendoni se institucionet tona reagojnë në mënyrë të duhur kur bëhet fjalë për parandalimin dhe ndëshkimin e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit ndaj grave të reja ose vajzave?

1. Po, plotësisht
2. Pjesërisht
3. Jo
4. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

A06. [S] A mendoni se keni informacione të mjaftueshme për të identifikuar dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin dhe të kërkonti mbrojtje?

1. Po
2. Jo
3. Pjesërisht
4. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

A07. [M-rotacioni i përgjigjeve] Cilat janë arsytet më të shpeshta pse dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi nuk raportohet?

1. Frika
2. Turpi
3. Fajësia
4. Mosbesimi në institucione
5. Presioni familjar
6. Presioni nga mjedisi
7. Presioni nga miqtë/shoqet
8. Nuk ka ku të raportohet
9. Mospasje të qasjes në mbështetjen falas (mbështetje falas psikologjike dhe ligjore, etj.)
10. Informimi i pamjaftueshëm ku të raportohet
11. Tjetër:
12. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme disa përgjigje

A08. A mendoni se ekzistojnë shërbime të qasshme, shërbime rinore dhe të ndjeshme gjinore për mbështetjen e viktimave të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit?

1. Po, mendoj se ekzistojnë dhe janë të qasshme
2. Po, ekzistojnë, por mendoj se nuk janë mjaftueshëm të qasshme
3. Jo, mendoj se nuk ekzistojnë
4. Nuk e di/nuk mund të vlerësoj (MOS LEXO!!)
5. Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

A09. [S sipas radhitjes - rotacioni i përgjigjeve]. Sa pajtoheni me deklaratat e mëposhtme, ku 1 do të thotë 'aspak nuk pajtohem' ndërsa 5 do të thotë 'plotësisht pajtohem'?

	Aspak nuk pajtohem	Deri diku nuk pajtohem	As pajtohem as nuk pajtohem	Deri diku pajtohem	Plotësisht pajtohem	Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]
Dhuna në familje është një çështje private dhe duhet të zgjidhet brenda familjes.	1	2	3	4	5	6
Dhuna ndaj grave/vajzave shpesh shkaktohet nga vetë viktimat.	1	2	3	4	5	6
Gratë/vajzat që deklarojnë se janë abuzuar shpesh trillojnë ose ekzagjerojnë me pohimet e abuzimit ose përdhunimit	1	2	3	4	5	6
Gratë/vajzat përdhunohen më shpesh nga persona të panjohur sesa nga dikush që ata e njohin.	1	2	3	4	5	6
Nëse partneri ose bashkëshorti/i dashuri është i dhunshëm ndaj partneres/gruas/të dashurës, atëherë duhet të intervenojnë njerëzit e tjerë jashtë familjes.	1	2	3	4	5	6
Është e rëndësishme që burri t'ij tregojë partneres së tij se kush është kryesori në lidhje.	1	2	3	4	5	6

	Aspak nuk pajtohem	Deri diku nuk pajtohem	As pajtohem as nuk pajtohem	Deri diku pajtohem	Plotësisht pajtohem	Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]
Gruaja duhet të ketë të drejtë t'i zgjedhë miqtë e saj, madje edhe nëse partneri i saj nuk pajtohet.	1	2	3	4	5	6
Është detyrim i gruas ose partneres të ketë marrëdhënie seksuale me partnerin e saj, madje edhe kur ajo nuk dëshiron.	1	2	3	4	5	6
Komenti i padëshiruar me konotacion seksual nuk është ngacmim seksual.	1	2	3	4	5	6
Nëse një vajzë i kundërshtohet ose mbron veten, kjo vetëm e përkeqëson sjelljen e djalit.	1	2	3	4	5	6
Vajzat që vishen në mënyrë provokuese tërheqin sjellje të dhunshme.	1	2	3	4	5	6
Vajzat dhe gratë e reja nga grupe të caktuara etnike janë më të ekspozuara ndaj rrezikut nga dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi.	1	2	3	4	5	6
Vajzat dhe gratë e reja me status më të ulët socio-ekonomik janë më të ekspozuara ndaj dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit.	1	2	3	4	5	6

	Aspak nuk pajtohem	Deri diku nuk pajtohem	As pajtohem as nuk pajtohem	Deri diku pajtohem	Plotësisht pajtohem	Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]
Përkatësia etnike e vajzave dhe grave të reja ndikon në mënyrën se si trajtohen kur janë viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit.	1	2	3	4	5	6
Statusi socio ekonomik i vajzave dhe grave të reja ndikon në mënyrën se si trajtohen kur janë viktimat të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit.	1	2	3	4	5	6
Vajzat dhe gratë e reja nga mjediset rurale janë më të ekspozuara ndaj rrezikut nga dhuna me bazë gjinore.	1	2	3	4	5	6
Vajzat dhe gratë e reja me aftësi të kufizuara janë më të ekspozuara ndaj rrezikut nga dhuna me bazë gjinore.	1	2	3	4	5	6

Një përgjigje në rregull

FORMAT DHE PËRHAPJA E DHUNËS ME BAZË GJINORE DHE/ OSE NGACMIMIT

A10. [M - deri në 3 përgjigje - rrotacioni i përgjigjeve] Cili është problemi më i madh me të cilin ballafaqoheni aktualisht?

1. Problemet financiare/pasiguria ekonomike
2. Problemet në lidhje me shëndetin mendor (stresi, ankthi, depresioni, etj.)
3. Ndjenja e pasigurisë në hapësirën publike
4. Ndjenja e pasigurisë, në banesë
5. Ndjenja e pasigurisë onlajn (ngacmim onlajn, bulingu kibernetik ose ngacmimi seksual)
6. Dhuna ose kontrolli nga partneri/ja
7. Diskriminimi
8. Qasje e kufizuar në arsim / mundësi zhvillimore
9. Përdorimi ose abuzimi i alkoolit, drogës dhe ilaçeve (tek ajo ose te persona të afërt)
10. Dhuna e bashkëmoshatarëve (përrjashtimi nga shoqëria, presioni nga bashkëmoshatarët, etj.)
11. Tjetër (ç'ka?)
12. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme deri në 3 përgjigje

A11. Deri në cilën shkallë ndiheni e sigurt si grua/ vajzë

	Plotësisht e sigurt	E sigurt	E pasigurt	Aspak e sigurt	Nuk e di/ Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]
1) ...në fqinjësinë tuaj?	1	2	3	4	9
2) ...në qytetin/ fshatin tuaj?	1	2	3	4	9
3) ...në shtetin tuaj?	1	2	3	4	9
4) ...në hapësirën digjitale?	1	2	3	4	9
5) ...në transportin publik?	1	2	3	4	9
6) ... në vende publike (si sheshe, parqe, rrugë urbane dhe inter urbane, shtigje për ecje dhe çiklizëm)?	1	2	3	4	9
7) Në institucionet arsimore	1		2	3	4

Një përgjigje në rregull

A12. A keni qenë ndonjëherë (nga mosha 15 vjeç) viktimë e ndonjë lloji të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi në hapësirë publike (shkollë, fakultet, rrugë, punë, në institucione)?

Për secilën nga format e mëposhtme të dhunës, ju lutemi përgjigjuni me po, jo, ose nuk jam e sigurt

	Po (1)	Jo (2)	Nuk jam e sigurt (3)	Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO] (4)
1) Dhuna fizike (goditja, shtyrja, grushtimi, tërheqja zvarrë, etj.)	1	2	3	4
2) Dhuna psikologjike (fyerje, nënçmimi, manipulimi, shantazhe, kërcënime)	1	2	3	4
3) Dhuna verbale (bërtitje, sharje, ndërhyrja me fjalë, poshtërimi)	1	2	3	4
4) Ngacmimi seksual (komente të padëshiruara, gjestikulacione, prekje të palejuara, presione për marrëdhënie seksuale)	1	2	3	4
5) Dhuna seksuale (kontakti seksual me forcë, përdhunimi)	1	2	3	4
6) Dhuna ekonomike (kontrolli ose kufizimi i financave, kushtëzimi monetar)	1	2	3	4
7) Vëzhgimi/ndjekja (ndjekja fizike, prania pa lejen tuaj)	1	2	3	4
8) Kontrolli nga partneri (gjatë lëvizjes, zgjedhjes së miqve/mikeshave, ndjekjes së komunikimeve telefonike, mënyrës së veshjes dhe sjelljes)	1	2	3	4

Një përgjigje në rregull

Baza: të anketuarat me kodin 1 të çdo deklaratë nga A12

A13. [M - rotacioni i përgjigjeve] Ju lutem më tregoni se ku e keni përjetuar dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin.

Scripter: Ask for each statement from A18 with answer 1 separately

1. Në banesë
2. Në fqinjësi
3. Në shkollë
4. Në fakultet
5. Në spital
6. Në park
7. Në rrugë
8. Në kafene, restorant ose klub
9. Në hapësirë parkimi
10. Në transportin publik
11. Në stacionin e policisë
12. Në shtëpinë e mikut/es
13. Në vendin e punës
14. Në internat/konviktin e studentëve
15. Tjetër
16. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme disa përgjigje

Baza: të gjitha të anketuarat

A14. A keni qenë ndonjëherë (nga mosha 15 vjeç) dëshmitare e ndonjë lloji të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi në hapësirë publike (shkollë, fakultet, rrugë, punë, në institucione)?

Për secilën nga format e mëposhtme të dhunës, ju lutemi përgjigjuni me po, jo, ose nuk jam e sigurt

	Po (1)	Jo (2)	Nuk jam e sigurt (3)	Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO] (4)
1) Dhuna fizike (goditja, shtyrja, grushtimi, tërheqja zvarrë, etj.)	1	2	3	4
2) Dhuna psikologjike (fyerje, nënçmimi, manipulimi, shantazhe, kërcënime)	1	2	3	4
3) Dhuna verbale (bërtitje, sharje, ndërhyrja me fjalë, poshtërimi)	1	2	3	4
4) Ngacmimi seksual (komente të padëshiruara, gjestikulacione, prekje të palejuara, presione për marrëdhënie seksuale)	1	2	3	4
5) Dhuna seksuale (kontakti seksual me forcë, përdhunimi)	1	2	3	4
6) Dhuna ekonomike (kontrolli ose kufizimi i financave, kushtëzimi monetar)	1	2	3	4
7) Vëzhgimi/ndjekja (ndjekja fizike, prania pa lejen tuaj)	1	2	3	4
8) Kontrolli nga partneri (gjatë lëvizjes, zgjedhjes së miqve/mikeshave, ndjekjes së komunikimeve telefonike, mënyrës së veshjes dhe sjelljes)	1	2	3	4

Baza: të anketuarat me kodin 1 të çdo deklarate nga A12

A15. [M - rotacioni i përgjigjeve] Ju lutem më tregoni se ku keni qenë dëshmitare e dhunës me bazë gjinore.

Scripter: Ask for each statement from A20 with answer 1 separately

1. Në banesë
2. Në fqinjësi
3. Në shkollë
4. Në fakultet
5. Në spital
6. Në park
7. Në rrugë
8. Në kafene, restorant ose klub
9. Në hapësirë parkimi
10. Në transportin publik
11. Në stacionin e policisë
12. Në shtëpinë e mikut/es
13. Në vendin e punës
14. Në internat/konviktin e studentëve
15. Tjetër
16. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme disa përgjigje

Baza: të anketuarat me përgjigjen 1) Po nga A18 dhe A14

A16. [S] A e keni raportuar incidentin?

1. Po, ku _____
2. Jo
3. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

Baza: të anketuarat me përgjigjen 1) nga A12 dhe A14

A17. [M - rrotacioni i përgjigjeve]. Çfarë ndërmorët pas përjetimit të incidentit?

1. E raportova në polici
2. Iu drejtova një qendre për punë sociale ose një institucioni tjetër
3. Kërkova ndihmë mjekësore
4. Kërkova mbështetje psikologjike ose këshillim
5. Kërkova ndihmë juridike (avokat, ndihmë juridike falas, etj.)
6. Bisedova me një person të afërt (mik, familjar, mësimdhënës/e, etj.)
7. U largova nga mjedisi i dhunshëm (puna, lidhja, banesa, etj.)
8. E kontaktova linjën SOS për ndihmë dhe mbështetje
9. Iu drejtova Qendrës së Referimit të Viktimave të Dhunës Seksuale dhe Përdhunimit
10. Tjetër (ju lutemi specifikoni):
11. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme disa përgjigje

Baza: të anketuarat me përgjigjen 2) nga A16

A18. [M-rotacioni i përgjigjeve]Pse nuk e raportove dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin?

1. Frika
2. Turpi
3. Fajësia
4. Mosbesimi në institucionet
5. Presioni familjar
6. Presioni nga mjedisi
7. Presioni nga miqtë/shoqet
8. Nuk ka ku të raportohet
9. Mospasje të qasjes në mbështetjen falas (mbështetje falas psikologjike dhe ligjore, etj.)
10. Informim i pamjaftueshëm ku të raportohet
11. Tjetër:
12. Doja, por nuk e dija ku
13. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme disa përgjigje

Baza: të anketuarat me përgjigjen 1) nga A12 dhe A14

A19. [M - rotacioni i përgjigjeve] Sipas mendimit tuaj, çfarë mungon më shumë në veprimet e institucioneve në rastet e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit?

1. Reagimi i shpejtë dhe adekuat
2. Mbrojtja dhe mbështetja e viktimës
3. Persona zyrtarë të trajnuar dhe të informuar
4. Ndëshkimi i duhur i kryerësve
5. Informimi dhe parandalimi
6. Bashkëpunimi ndërinstitucional
7. Tjetër:
8. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme disa përgjigje

A20. [M - deri në 3 përgjigje, rotacioni i përgjigjeve] Çfarë do të ndihmonte për sigurinë më të madhe të grave të reja dhe vajzave në hapësirën publike?

1. Ndriçimi më i mirë dhe infrastruktura e sigurisë, siç është video mbikëqyrja
2. Prania më e madhe e policisë
3. Reagimi më i shpejtë i institucioneve kompetente mbas raportimeve
4. Më shumë fushata informative dhe edukuese për identifikimin dhe parandalimin e dhunës me bazë gjinore dhe ngacmimit
5. Informacione publikisht të qasshme të shërbimeve ekzistuese për viktimat e dhunës me bazë gjinore
6. Mbështetja nga institucionet (shërbimet sociale, policia, gjyqësori) - këshillime, mundësia e raportimit anonim, mbrojtja ligjore, trajtimi i drejtë, etj.
7. Qëndrueshmëria e shërbimeve ekzistuese për viktimat e dhunës me bazë gjinore dhe ngacmimit si dhe hapja e shërbimeve të tjera të specializuara
8. Qendrat/Organizatat Rinore për raportim dhe ndihmë
9. Tjetër (ju lutemi specifikoni):
10. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme deri në 3 përgjigje

A21. [M]Si mund të bëhen institucionet më të qasshme dhe më të besueshme për gratë e reja dhe vajzat ?

1. Të ofrojnë informacione në gjuhë të qartë dhe të kuptueshme
2. Të kenë shërbime të specializuara ose persona për kontakt për gratë e reja/ vajzat
3. Të garantojnë besueshmëri dhe mbrojtje të të dhënave personale
4. Të zhvillohen fushata për rritjen e ndërgjegjësimit dhe besimit të rinjtë
5. Të kenë qasje të lehtë fizike dhe online në shërbimet (pa procedura komplekse)
6. Të përfshijnë gra të reja dhe vajza në politikëbërje dhe shërbime
7. Tjetër:
8. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme disa përgjigje

MJEDISI ONLINE DHE DHUNA DIGJITALE

A22. [S] A keni qenë ndonjëherë (nga mosha 15 vjeç) viktimë e ndonjë forme të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit në hapësirën digjitale (në rrjetet sociale, mesazhet sms, e-postën, forumet, thirrjet telefonike, lokalizuesit GPS, etj.)?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

Baza: Të anketuarat me përgjigjen 1) nga A22

A23. [M - rotacioni i përgjigjeve] Cila nga format e mëposhtme të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit i keni përjetuar në hapësirën digjitale?

1. Mesazhe ose komente ofenduese apo nënçmuese
2. Mesazhe seksualisht eksplicite pa pëlqim
3. Shkëmbimi i regjistrimeve ose fotografive eksplicite intime pa pëlqim
4. Vëzhgimi onlajn (stalking)
5. Thirrjet telefonike ose SMS mesazhet
6. Kërcënime për jetën ose sigurinë
7. Krijimi i përmbajtjeve dhe materialeve me përmbajtje seksuale duke përdorur inteligjencën artificiale pa leje

8. Sekstorsion (kërcënime dhe shantazhe për publikimin e përmbajtjeve intime
9. Profil i rremë(fake profile)
10. Tjetër (ju lutemi specifikoni):
11. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme disa përgjigje

A24. [S] A keni qenë ndonjëherë (nga mosha 15 vjeç) dëshmitare e ndonjë forme të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit në hapësirën digjitale (në rrjetet sociale, mesazhet, e-postën, forumet, etj.)?

1. Po
2. Jo
3. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

Baza: Të anketuarat me përgjigjen 1) nga A24

A25. [M - rotacioni i përgjigjeve] Në cila nga format e mëposhtme të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit në hapësirën digjitale keni qenë dëshmitare?

1. Mesazhe ose komente ofenduese apo nënçmuese
2. Mesazhe seksualisht eksplicite pa pëlqim
3. Shkëmbimi i regjistrimeve ose fotografive eksplicite intime pa pëlqim
4. Vëzhgimi onlajn (stalking)
5. Thirrjet telefonike ose SMS mesazhet
6. Kërcënime për jetën ose sigurinë
7. Krijimi i fotografive, përmbajtjeve dhe video materialeve private me përmbajtje seksuale duke e përdorur inteligjencën artificiale pa leje
8. Sekstorsioni (kërcënime dhe shantazhe për publikimin e përmbajtjeve intime)
9. Profil i rremë (fake profile)
10. Tjetër (ju lutemi specifikoni):
11. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme disa përgjigje

Baza: Të anketuarat me përgjigjen 1) nga A22 dhe A24

A26. [M]Në cilat platforma keni përjetuar ose keni qenë dëshmitarë të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit?

1. Facebook
2. Instagram
3. TikTok
4. WhatsApp/Viber
5. X (Twitter)
6. Snapchat
7. Youtube
8. Discord
9. Telegram
10. Tjetër:
11. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme disa përgjigje

Baza: Të anketuarat me përgjigjen 1) nga A22 dhe A24

A27. [S] A e keni raportuar incidentin e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit të cilin e keni përjetuar ose dëshmuar?

1. Po- Ku: _____
2. Jo
3. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

Baza: Të anketuarat me përgjigjen 2) nga A22 dhe A24

A28. [M- rotate the answers] Për cilat arsye nuk e raportuat dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin në hapësirën digjitale?

1. Frika
2. Turpi
3. Fajësia
4. Mosbesimi në institucionet
5. Presioni familjar
6. Presioni nga mjedisi
7. Presioni nga miqtë/shoqet
8. Nuk ka ku të raportohet

9. Mospasje të qasjes në mbështetjen falas (mbështetje falas psikologjike dhe ligjore, etj.)
10. Informim i pamjaftueshëm ku të raportohet
11. Tjetër:
12. Doja, por nuk e dija ku
13. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme disa përgjigje

Baza: Të anketuarat me përgjigjen 1) nga A22

A29. [M- rotate the answers] Çfarë keni ndërmarrë mbas përjetimit të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit në hapësirën digjitale?

1. E bllokova profilin/numrin e dhunuesit
2. E raportova profilin/postimin në rrjetin ose platformën sociale
3. Kërkova ndihmë nga miku/mikesha ose familja
4. U drejtova në polici ose në një institucion tjetër
5. Iu drejtova organizatës qytetare që i trajton këto tema
6. Kërkova ndihmë ose këshillim psikologjik
7. U tërhoqa nga aktiviteti online (fshiva profilin, ndërpreva përdorimin e platformave)
8. Nuk shkarkova asgjë
9. Tjetër (ju lutemi specifikoni):
10. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme disa përgjigje

A30. [M deri në 3 përgjigje-rotacioni i përgjigjeve] Cilët faktorë kontribuojnë në dhunën me bazë gjinore dhe/ose ngacmimin në hapësirën digjitale?

1. Anonimiteti i sulmuesve
2. Platforma të rregulluara jo sa duhet
3. Mungesa e sanksioneve dhe pasojave
4. Përhapja e lehtë dhe e shpejtë e përmbajtjeve fyese
5. Edukimi i pamjaftueshëm për të drejtat digjitale
6. Presioni grupor dhe nevoja e pranimi nga bashkëmoshatarët
7. Normalizimi i vokabularit agresiv dhe sjellja e dhunshme në internet
8. Tjetër:
9. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme deri në 3 përgjigje

A31. [M - deri në 3 përgjigje, rotacioni i përgjigjeve] Çfarë do të ndihmonte për sigurinë më të madhe të grave të reja dhe vajzave në hapësirën digjitale?

1. Instrumentet digjitale për raportimin dhe bllokimin e dhunuesve
2. Mbështetja nga institucionet (institucionet arsimore, shërbimet sociale, policia, gjyqësori) - siç janë këshillimet dhe mbështetja psikologjike, mundësia e raportimit anonim, mbrojtja ligjore dhe trajtimi i drejtë, etj.
3. Trajnime për të rinjtë për identifikimin dhe luftimin e dhunës digjitale
4. Ekzistimi i rregullave të qarta dhe të rrepta të sjelljes në platformat online
5. Hapësira më të sigurta dhe më të moderuara online për të rinjtë
6. Më shumë fushata informative dhe edukative për identifikimin dhe parandalimin e dhunës digjitale
7. Tjetër (ju lutemi specifikoni):
8. Nuk e di/Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Janë të mundshme deri në 3 përgjigje

DEMOGRAFIA

S04. [M] A keni ndonjë lloj aftësie të kufizuar ose gjendje shëndetësore që ndikon në funksionimin tuaj të përditshëm?

1. Dëmtimi i shikimit (tërësisht ose pjesërisht)
2. Dëmtim i dëgjimit
3. Aftësi të kufizuara trupore;
4. Aftësia e kufizuar intelektuale
5. Aftësitë e kufizuara neuro-zhvillimore (p.sh. spektri i autizmit, ADHD, etj.)
6. Gjendja psiko-sociale (p.sh. depresioni, anksoziteti, PTSD, etj.)
7. Sëmundja kronike që ndikon në funksionimin e përditshëm
8. Abuzimi me alkoolin, drogën ose ilaçet
9. Tjetër (ju lutemi specifikoni):
10. Nuk kam ndonjë aftësi të kufizuar [S]
11. Preferoj të mos përgjigjem [S]

Janë të mundshme disa përgjigje

S05. [S] Cila është përkatësia juaj etnike?

1. Maqedonase
2. Shqiptare
3. Rome
4. Tjetër (ju lutemi shënoni)
5. Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

S06. [S] Cili është niveli më i lartë i arsimit që e keni kryer?

1. Nuk kam arsim formal
2. Arsimi fillor
3. Arsimi i mesëm
4. Arsimi i lartë
5. Magjistraturë
6. Doktoratë
7. Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

S07. [S] Cili është statusi juaj aktual i punës?

1. Punonjëse e rregullt
2. Përkohësisht/joformale
3. E papunësuar
4. Studente/nxënëse
5. Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

S08. [S] Sa janë të ardhurat e përgjithshme mujore të familjes suaj?

1. Deri në 24,000 denarë
2. Nga 24001 deri në 34.000 denarë
3. Nga 34.001 deri në 44.0000 denarë
4. Nga 44,001 deri në 54,000 denarë
5. Nga 54,001 deri në 64,000 denarë
6. Mbi 64.001 denarë
7. Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

S09. [S] Sa janë të ardhurat tuaja personale mujore?

1. Nuk kam të ardhura
2. Deri në 24,000 denarë
3. Nga 24001 deri në 34.000 denarë
4. Nga 34.001 deri në 44.0000 denarë
5. Nga 44,001 deri në 54,000 denarë
6. Nga 54,001 deri në 64,000 denarë
7. Mbi 64.001 denarë
8. Refuzon të përgjigjet [MOS LEXO]

Një përgjigje

FUNDI I PYETËSORIT

Faleminderit shumë për pjesëmarrjen në hulumtimin

Aneksi 2 - Udhëzuesi i diskutimit në grupet fokus

Numri i grupeve dhe numri i pjesëmarrësve për grup: katër (4) grupe fokus, 8-10 pjesëmarrës në grup

Lokacioni: Shkup (katër fokus grupe)

Grupi i synuar: Profesionistë / Organizata

Faza 1: Hyrje (5 min.)

(Përshkrim i shkurtër i objektivave të diskutimit, rregullat e diskutimit dhe inkurajimi i pjesëmarrësve për të marrë pjesë në mënyrë aktive në diskutim)

Moderatori: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në diskutimin e sotëm në grupin fokus. Faleminderit që e ndatë kohën për të ardhur sot dhe të merrni pjesë në diskutimin e planifikuar. Emri im është (...) dhe sot do të diskutojmë për **pikëpamjet dhe mendimet tuaja mbi perceptimet dhe sfidat me të cilat ballafaqohen gratë e reja dhe vajzat të moshës prej 18 deri në 29 vjeç për sa i përket dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit, si në hapësirën publike ashtu edhe në atë digjitale.**

Diskutimi do të regjistrohet, sepse thjesht nuk është e mundur të mbahet mend gjithçka që do të diskutohet, që është shumë e rëndësishme për ne. Nuk do t'ju ftoj ta artikulonim mendimin tuaj, por prej jush pritët të diskutoni në mënyrë aktive ndaj temave që do të hapen në diskutimin e sotëm. Të gjitha mendimet tuaja janë jashtëzakonisht të rëndësishme për ne, pavarësisht se sa të ndryshme janë. Qëllimi ynë nuk është të kemi një qëndrim të vetëm, por t'i dëgjojmë të gjitha mendimet, edhe ato të ndryshmet madje edhe mendimet e kundërta.

Edhe një herë, ju lutem mos ngurroni të merrni pjesë, por dua t'ju lus që të mos e ndërprisni njëri-tjetrin dhe të mos flisni në të njëjtën kohë. Një gjë e tillë nuk mund të regjistrohet, përkatësisht më vonë, ne nuk do të jemi në gjendje të kuptojmë dhe analizojmë atë që është thënë dhe diskutuar. Pra, ju lutem, të flasim njëri pas tjetrit.

Tani do ju lusja të njoftohemi. Ju lutem secili prej jush të prezantohet personalisht

- ▶ **Prezantim i shkurtër i pjesëmarrësve**
- ▶ **Emri dhe mbiemri**
- ▶ **Nga cilat organizata vini**
- ▶ **Qëllimi kryesor i organizatës**

* * *

Faza 2: Perceptimet dhe besimi në institucione (15 min.)

- ▶ **Si e sheh organizata juaj problemin e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit midis grave të reja dhe vajzave?** A mendoni se është rritur, ulur apo problemi është në nivelin e njëjtë në krahasim me vitin 2024?
- ▶ **Sa mendoni se gratë e reja dhe vajzat kanë besim në institucionet** (policia, gjykatat, qendrat për punë sociale, institucionet shëndetësore dhe arsimore)? *Me se ka të bëjë niveli i besimit apo mosbesimit?*
- ▶ **Sipas mendimit tuaj, cilat institucione ose organizata duhet të kenë një rol kryesor në aspektet e ndryshme të luftimit të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit?** Pse?
 - ✓ në parandalimin dhe edukimin
 - ✓ në identifikimin dhe raportimin
 - ✓ në mbrojtjen dhe mbështetjen e viktimave
 - ✓ në sanksionimin dhe ndëshkimin e kryerësve
 - ✓ në koordinimin ndërinstitutional
- ▶ **Sipas përvojës tuaj çfarë mungon më së shumti (nëse jeni të mendimit se mungon) në veprimin e institucioneve** (për shembull: reagimi i shpejtë, qasja e ndjeshme, koordinimi, shërbimet e specializuara, mbështetja e viktimave, besueshmëria)?

Faza 3: Format dhe përhapja e dhunës (20 min.)

- ▶ **Cilat forma të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit i hasni më shpesh, në punën tuaj, te gratë e reja dhe vajzat (fizike, psikologjike, verbale, seksuale, ekonomike, digjitale, të tjera)?** *Moderatori e parashtrohet pyetjen: Pse pikërisht ato? A ka forma që janë më pak të dukshme, por megjithatë të pranishme? Sqaroni!*
- ▶ **A mendoni se grupe të caktuara të vajzave dhe grave të reja janë më shumë të ekspozuara ndaj rrezikut nga dhuna me bazë gjinore dhe/ose ngacmimi se të tjerat?** *Moderatori e parashtrohet pyetjen: Nëse po, cilat grupe do t'i veçonit dhe pse? (Për shembull: vajzat nga mjediset rurale, bashkësitë etnike, ato nga familjet me status më të ulët socio-ekonomik, vajzat me aftësi të kufizuara)? Në ç 'mënyrë ato grupe janë më shumë të ekspozuara? A i identifikojnë institucionet dhe organizatat mjaftueshëm këto specifika?*
- ▶ **Ku më së shpeshti ndodhin këto forma të dhunës?** *Moderatori e parashtrohet pyetjen: Në hapësirë publike (rrugë, transport publik, shkolla, fakultete)? Në familje apo lidhje intime? Në hapësirën digjitale? Sqaroni!*
- ▶ **Si e identifikojnë dhe regjistrojnë organizatat problemin?** *Moderatori e parashtrohet pyetjen: A keni mekanizma të juaj për identifikimin e rasteve? A ju drejtohen vajzat/gratë drejtpërdrejt? Me cilat barriera ballafaqoheni gjatë raportimit ose mbështetjes?*

- ▶ **Sipas mendimit tuaj, cila është “pjesa e padukshme” e problemit – dhuna që shpesh injorohet, nuk raportohet ose nuk identifikohet si e tillë? Moderator i e parashtrohet pyetjen: A mendoni se ka sjellje të cilat gratë e reja dhe vajzat nuk i identifikojnë si dhunë (p.sh.: kontrolli nga partneri, shakatë fyese, komentet e seksualizuara)?**
- ▶ **Cilat forma të dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit minimizohen më së shpeshti (nuk merren seriozisht) nga institucionet ose shoqëria? Kur një institucion (policia, gjykata, qendra për punë sociale) konsideron se dhuna verbale ose psikologjike “nuk është aq e rëndësishme” dhe nuk ndërmerr masa. Kur shoqëria (mjedisi, familja, media) e/i sheh kontrollin e lidhjes, komentet e seksualizuara, shakatë fyese ose kontaktin fizik të padëshiruar si diçka “normale” ose si “shaka”.**

Faza 4: Raportimi dhe barrierat (15 min.)

- ▶ **Sipas mendimit tuaj cilat janë arsyet më të shpeshta pse gratë e reja dhe vajzat nuk i raportojnë rastet e dhunës me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit? Moderator i e parashtrohet pyetjen: A ndodh kjo më së shpeshti për shkak të frikës (nga dhunuesi, nga pasojat, nga stigma)? A mendoni se ka ndjenjë turpi apo faji? Sa rol luan mosbesimi në institucionet? A ekziston informimi i pamjaftueshëm se ku dhe si mund të raportohet? A ka presione kulturore ose familjare që i dekurajojnë vajzat të raportojnë?**
- ▶ **Si mund të kontribuojnë organizatat në rritjen e raportimit dhe besimit në institucione? Moderator i e parashtrohet pyetjen: Cilat aktivitete ose programe do t’i ndihmonin vajzat të ndihen të inkurajuar për të raportuar?**
- ▶ **Nëse nuk është specifikuar, pyesni: A ka organizata juaj përvojë në krijimin e mekanizmave për raportim anonim? Si mund të përmirësohet bashkëpunimi midis organizatave dhe institucioneve për mbështetje më efektive? Sipas mendimit tuaj, a kanë efekt real fushatat publike dhe edukimi?**
- ▶ **Cilat shërbime mbështetëse mendoni se janë më të rëndësishmet (juridike, psikologjike, mjekësore, të tjera)? Çfarë lloj mbështetjeje kërkojnë më shpesh viktimat? Cilat shërbime mendoni se janë më pak të qasshme? A ka mjaftueshëm shërbime të specializuara për gratë e reja (p.sh. qendrat rinore, këshillat online)? Si mund të ndihmojnë organizatat në mbushjen e boshllëqeve ku institucionet nuk ofrojnë mbështetje të mjaftueshme?**

Faza 5: Dhuna digjitale (10 min.)

- ▶ **A ballafaqohet organizata juaj me raste të dhunës digjitale me bazë gjinore dhe/ose ngacmimit?** Nëse po, cilat raste janë më të shpeshta (p.sh.: mesazhet fyese, profilet e rreme, kërcënimet, ndarja e fotografive intime pa leje, vëzhgimi onlajn)?
- ▶ **Cilat platforma mendoni se janë më të rrezikshmet për gratë e reja dhe vajzat? Moderatorit e parashtrohet pyetjen:** Cilat forma të ngacmimit janë më të shpeshta në ato platforma? A ka ndonjë ndryshim midis kanaleve publike dhe private (grupe, mesazhe, komente)?
- ▶ **A kanë gratë e reja dhe vajzat besim të mjaftueshëm për të raportuar dhunën digjitale tek institucionet?** Nëse po, ku raportohet më shpesh? Nëse jo, pse jo? Sqaroni!
- ▶ **Si mund ta lehtësojnë organizatat mbështetjen e viktimave të dhunës digjitale?** Si mund të përmirësohet mbrojtja në hapësirën digjitale (çfarë mund të bëjnë institucionet, OJQ-të, mediat, etj...)?

Faza 6: Zgjidhje dhe rekomandime (20 min.)

- ▶ **Cilat masa parandaluese do të ndihmonin më së shumti në rritjen e sigurisë në hapësirën publike?** Cilat masa infrastrukturore në hapësirën publike do të ishin të dobishme (ndriçimi, kamerat e sigurisë, prania e policisë) Cilat aktivitete arsimore dhe informative do të kishin efekt më të madh?
- ▶ **Çfarë mund të bëhet në hapësirën digjitale për të rritur sigurinë (instrumentet e raportimit, moderimi, programe edukative)?** Sqaroni!
- ▶ **Si mund të bëhen institucionet më të qasshme dhe më të besueshme për gratë e reja dhe vajzat?** Çfarë duhet të ndryshohet në mënyrën e punës (procedura më të thjeshta, besueshmëria, reagimi i shpejtë)? A është e nevojshme të ketë më shumë shërbime të specializuara ose persona për kontakt? Si mund të krijojnë besim afatgjatë me gratë e reja dhe vajzat?
- ▶ **Si mund të bashkëpunojnë më mirë organizatat qytetare me institucionet dhe bashkësinë?** Cilat janë sfidat kryesore në bashkëpunimin aktual?
- ▶ **A mund të propozoni një masë ose iniciativë kryesore që do ta bënte ndryshimin më të madh - cili do të ishte ai dhe cilin problem do ta zgjidhte?** (**Moderatori:** Si do të dukej në praktikë (cilat aktivitete, cilat institucione ose organizata do të përfshiheshin)? Çfarë do të nevojitej për tu realizuar (resurse, vullneti politik, partneritetet)?

 OSCE.Skopje

 osce_skopje

OSCE Mission to Skopje
Bulevar 8-mi Septemvri No. 16
1000 Skopje

 info-MK@osce.org

 osce.org/mission-to-skopje